Wadephul kërkon formim të shpejtë të një qeverie stabile



Faqe 2

Evropa pa mekanizëm të përbashkët për t'u përballur me agresionin hibrid rus



Faqe 3

Shirat e dendura shkaktuan edhe përmbytje



Faqe 5

Këshilli i Sigurimit miraton Rezolutën e ndërmjetësuar nga SHBA-ja për Gazën



Faqe 6

KOHA DITORE

e mërkurë • 19 nëntor 2025

Numri 10190

www.koha.net

BEST VALUE FOR MONEY BestBuy AWARDS RESEARCH • CERTIFICATE • AWARD

KUVENDI MBAN DY SEANCA, PAS SË CILAVE VENDI MUND TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA

PDK, LDK, AAK e Nisma: S'ka votë as për buxhet, as për Qeveri

Dy seanca të ndara do të mbahen të mërkurën me kërkesë të Lëvizjes Vetëvendosje, në ditën e fundit të afatit kushtetues për krijimin e Qeverisë. Në seancën e parë ku do të synohet formimi i komisioneve që i hapin rrugë sidomos shqyrtimit të buxhetit, subjektet politike PDK, LDK, AAK dhe Nisma kanë thënë se nuk do të marrin pjesë. Të njëjtat, ndonëse kanë konfirmuar pjesëmarrjen në seancën e dytë, janë deklaruar se nuk kanë votë për Qeverinë Konjufca. Nëse dështon votimi për Qeverinë, vendi shkon në zgjedhje të parakohshme

Marigona Brahimi

PRISHTINË, 18 NËNTOR – Propozimet e Lëvizjes Vetëvendosje kanë marrë përgjigje të prerë nga katër parti parlamentare, një ditë para se ato të rixirren për diskutim e miratim në Kuvendin e Kosovës, në dy seanca të ndara. Në seancën e parë ku do të synohet formimi i komisioneve, që i hapin rrugë veç tjerash edhe projektligjit të buxhetit 2026, subjektet politike PDK, LDK, AAK dhe Nisma kanë thënë se nuk do të marrin pjesë. Të njëjtat, ndonëse kanë konfirmuar pjesëmarrjen në se-ancën e dytë, janë deklaruar se nuk kanë votë për Glauk Konjufcën të mandatuarin e dytë për krijimin e qeverisë.

Seanca e parë që më kërkesë të 40 deputetëve të Vetëvendosjes është caktuar të mbahet në orën 11:00, parasheh nëntë pika të rendit të ditës. Në këtë seancë do të synohet formimi i komisioneve parlamentare e më pas shqyrtimi i pesë marrëveshjeve ndërkombëtare, shqyrtimi në lexim të parë i projektligjit për buxhetin për vitin 2026, miratimi i buxhetit për Komunën e Prishtinës, Gjilanit dhe Zubin- Potokut, si dhe trajtimi i çështjes së financimit të RTK-së.

Në arsyetimin për seancën e orës 11:00, ligjvënësit e Vetëvendosjes kanë theksuar se miratimi i çështjeve të listuara në rendin e ditës janë parakusht për funksionimin e rregullt të institucioneve.

"Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje vlerëson se çështjet e përcaktuara në rendin e ditës kërkojnë trajtim urgjent nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për shkak të rëndësisë së tyre institucionale, buxhetore dhe funksionale", thuhet në arsyetimin e LVV-së të shkruar në kërkesën për seancë.

Deputetja e Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, ka shprehur pritjet se të gjithë deputetët do të shprehin gatishmërinë për miratimin e këtyre vendimeve.

"Po shpresojmë që në seancë, për arsyet emergjente të cilat lidhen edhe me buxhetet e komunave, të marrin pjesë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe të tregojnë gatishmëri e vullnet për t'i tejkaluar ngarkesat e obligimet financiare të cilat mund të kryhen në legjislaturën e nëntë, para se të kalojmë në një votim tjetër", ka thënë Kusari-Lila.

vijon në faqen e dytë



Prishtinë, 18 nëntor – Kosova e Zvicra kanë barazuar 1:1, të martën mbrëma në "Fadil Vokrri". Barazimi ka konfirmuar vendin e Zvicrës në Botëror dhe vendin e Kosovës në plejofin kualifikues. Ndeshja nisi me fishekzjarrë, ndërsa e gjithë vëmendja ishte te fishkëllimat e shikuesve ndaj Granit Xhakës, kapitenit të Zvicrës. Pjesa e parë ishte e zbehtë, ndërsa golat u shënuan në pjesën e dytë. Ruben Vargas kaloi në epërsi 1:0 Zvicrën, ndërsa Florent Muslija shënoi supergol për të barazuar rezultatin në 1:1. Kosova të enjten e mëson kundërshtarin e gjysmëfinales së plejofit. Më 26 mars të vitit të ardhshëm do të luajë në udhëtim ndaj Polonisë, Uellsit, Çekisë apo Sllovakisë

EKSPERTË NDËRKOMBËTARË ALARMOJNË PËR RRITJEN E VARËSISË SË FËMIJËVE NGA CIGARET VAPE

OBSH-ja u kërkon shteteve t'i shtrëngojnë masat ndaj cigareve elektronike

Vlerë Mehmeti

GJENEVË, 18 NËNTOR – Rregullimi gjithëpërfshirës i produkteve me nikotinë dhe parandalimi i varësisë së të rinjve nga cigaret elektronike u kërkua me urgjencë, në seancën e 11-të të Konferencës së Palëve të Konventës Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për Kontrollin e Duhanit.

Në sallën e Qendrës Ndërkombëtare të Konferencës në Gjenevë, është duke i mbajtur punimet konferenca gjashtë ditore. Aty janë mbledhur më shumë se 1 mijë e 400 delegatë nga e gjithë bota në shënim të 20 vjetorit të Konventës të OBSh-së kundër duhanit, dhe kanë diskutuar mënyrat e luftimit të produkteve më të reja të duhanit. Konferenca nisi të hënën dhe prej dy ditësh është theksuar se cigaret elektronike me ngjyra, aroma dhe shije të ndryshme po përdoren gjerësisht nga fëmijët dhe se varësia që shkaktojnë është e lartë"

Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, tha se produktet e reja të nikotinës janë kërcënim në rritje dhe sfidë globale. Ai prezantoi të dhëna që tregojnë për përdorim në masë nga fëmijët, të cigareve elektronike të njohura si VAPE.

"Shkollat janë bërë fronti i ri në luftën kundër duhanit dhe nikotinës, ku kompanitë rekrutojnë një brez të ri të varurish. Raporti i fundit global i OBSH-së për rininë dhe duhanin vlerëson se pothuajse 15 milionë adoleshentë përdorin cigare elektronike. Në 63 vende, prevalenca e VAPE tek adoleshentët është mesatarisht nëntë herë më e lartë se tek të riturit", ka thënë Ghebreyesus. "Edhe pse cigaret elektronike promovohen si më të sigurta, nuk ka prova të përfitimit të tyre për shëndetin publik, ndërsa rreziqet janë gjithnjë më të larta. Kjo është një strategji e studiuar mirë që industria e duhanit përdor për të rekrutuar fëmijët tanë sa janë ende të vegjël. Kjo nuk ka të bëjë me reduktimin e dëmit. Prandaj thashë se ka të bëjë me prodhimin e dëmit. Dhe si prind, jam baba dhe gjysh, besoj se duhet t'i mbrojmë fëmijët tanë".

Në konferencë u prezantua e dhëna se një cigare elektronike mund të përmbajë nikotinë sa 9 paketa cigareje tradicionale.

vijon në faqen e pestë

Dresniku i mozaikëve unikë në kapitullin e radhës me 2.5 milionë euro



Mozaikët shumëngjyrësh të Dresnikut prej zbulimit të tyre, para më shumë se një dekade më parë, janë parë si potencial i madh i prezantimit të vlerave arkeologjike. Projekti për hapjen e tyre për vizitorë synon që lokaliteti arkeologjik i shekujve të parë të erës sonë krejt afër Klinës të shndërrohet në alamet pike turistike e reprezentative...

Faqe 11

KRYEDIPLOMATI I GJERMANISË, JOHANN WADEPHUL, QËNDROI PËR VIZITË NË PRISHTINË

Wadephul kërkon formim të shpejtë të një qeverie stabile, Osmani mbështetje për Kosovën

Para se të ftohet seanca për votimin e qeverisë, në Kosovë ka qëndruar për vizitë ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Johann Wadephul. Ai ka takuar presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. E gjatë vizitës, Wadephul ka shprehur pritjen për formimin e shpejtë të një qeverie, ndërsa ka thënë se stabiliteti i saj është vendimtar për rrugëtimin e Kosovës

Valbona Bytyqi

PRISHTINË, 18 NËNTOR – Pritjen për formimin e shpejtë të një qeverie stabile e ka shprehur të martën ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Johann Wadephul, gjatë vizitës së tij në Prishtinë.

Ai ka thënë se Evropa e ka drejtuar të gjithë vëmendjen kah Kosova dhe ka shtuar se formimi i një qeverie stabile është vendimtare për ecjen përpara të Kosovës në rrugën evropiane.

"Zhvillimi i Kosovës që nga përfundimi u luftës më 1999 dhe që nga pavarësia më 2008 është një histori e vërtetë suksesi. Për shumëkënd në rajon, Kosova është simbol i demokracisë dhe i një shoqërie të fortë civile. Në mënyrë që ky sukses të vazhdojë, Kosovës i duhet që sa më shpejt ta ketë një qeveri të aftë për veprim si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Votuesit janë duke e pritur formimin e saj që prej 8 muajsh. Ata kanë pritje të arsyeshme që këto procese demokratike të marrin një përfundim pozitiv dhe këtu bën pjesë edhe një qeveri stabile", ha thënë ai.

Gjatë vizitës në Prishtinë, Wadephul ka pasur takim me presidenten Vjosa Osmani dhe me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti.

Nga Wadephuli, Osmani e ka kërkuar mbështetjen e Gjermanisë për heqjen e masave që Bashkimi Evropian (BE) ia ka vendosur Kosovës, për anëtarësimin e saj në NATO, në BE dhe në Këshill të Evropës.

"Sepse si shtet gjithnjë kemi mbrojtur vlerat mbi të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë këto organizata. Në të gjithë këta mekanizma ndërkombëtarë ne synojmë të hyjmë si kontributdhënës e jo si barrë. Në këtë rrugëtim Kosova ka nevojë për mbështetjen e vendosur të Gjermanisë", ka thënë ajo në një konferencë të përbashkët shtypi me kryediplomatin gjerman, pas takimit të zhvilluar mes tyre.



Osmani ka thënë se në takim është folur edhe për procesin e dialogut mes Kosovës e Serbisë. Për këtë çështje presidentja Osmani ka kërkuar trajtim të barabartë të palëve ndërsa kryediplomati gjerman ka shprehur ankesë lidhur me ngecjen e procesit. Ai e ka vlerësuar si "shumë të rëndësishme" arritjen e një përparimi konkret.

"Marrëveshja e Ohrit, e cila i mban të gjitha elementet relevante për normalizim, duhet të zbatohet shpejt dhe në plotësi. Këtë e presim nga të dyja palët. Për këtë nevojitet më shumë angazhim si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia. Për Kosovën kjo nënkupton që, për shembull, të ndërmarrë hapa të nevojshëm për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe", ka deklaruar ai.

E Osmani ka thënë se shkaku i masave ndaj Kosovës, trajtimi i palëve në tavolinën e diskutimeve nuk është i drejtë dhe se procesi i dialogut duhet të jetë i balancuar dhe i barabartë.

"Për momentin tavolina nuk është e drejtë, sepse në njërën anë është Kosova, e cila është nën sanksione, nën masa. Në anën tjetër, është Serbia e cila, përkundër akteve të agresionit ndaj Kosovës, përkundër faktit që nuk e ka politikën e jashtme të linjëzuar me BE-në, e shumë e shumë arsye, fatkeqësisht nuk ka ndonjë masë ndaj tyre", është shprehur ajo.

Kosova ka aplikuar për t'u bërë pjesë e BE-së në dhjetor të 2022-tës. Që nga ajo kohë, aplikimi i saj ka mbetur në sirtarët e institucioneve të Bashkimit Evropian, pavarësisht se kush i ka drejtuar ato përgjatë këtyre tre vjetëve.

Osmani ka vlerësuar se Gjermania ka rol vendimtar që aplikacioni i Kosovës për anëtarësim në BE të procedohet në Komisionin Evropian (KE) ndërsa ka shprehur pajtim me qasjen e qeverisë së re gjermane se rruga drejt BE-së duhet të bazohet në merita.

"Nëse e krahasojmë Kosovën me shtet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ne kemi plotësuar shumë më shumë kritere, shumë më shumë detyra të shtëpisë, kemi progres shumë më të madh edhe në sundimin e ligjit, edhe në reforma ekonomike, edhe në fushën e të drejtave të njeriut, edhe në shumë fusha të tjera... por megjithatë jemi vendi i vetëm që nuk e ka statusin e kandidatit. Pra, progresi nuk është reflektuar në veprime konkrete nga BE-ja", ka thënë ajo.

I pyetur mbi arsyet e mosshqyrtimit të aplikacionit të Kosovës dhe se si do të veprohet në mënyrë që ky proces të shtyhet përpara, ministri gjerman ka përmendur dialogun dhe formimin e Asociacionit.

"Ne angazhohemi për atë që dialogu për normalizim në mes të Kosovës dhe Serbisë të çohet përpara me energji. Unë i kam theksuar disa herë në Beograd dhe këtu. Kjo temë ka qenë temë që e kemi diskutuar, që është më rëndësi që të ketë një pranim të detyrave nga ana e kryetarëve të qëndrur të komunave në veri dhe çështja e zbatimit të themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe ne kemi folur për këtë dhe shpresoj që të përfundohet me sukses", ka thënë Wadephul.

Çështja e anëtarësimit të Kosovës në BE është trajtuar si temë edhe në takimin që ministri gjerman e ka pasur në ambientet e Kuvendit me kryeministrin në detyrë. Sipas njoftimit të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, Kurti ka shprehur qëndrimin se Kosova meriton që ta marrë statusin e vendit kandidat dhe se "Komisioni Evropian duhet ta dorëzojë sa më parë pyetësorin për anëtarësim".

Sipas njoftimit, Kurti ka përmendur edhe sulmin në Banjskë dhe rrezikun nga grupi i Milan Radoiçiqit. "Kryeministri nënvizoi faktin se edhe më shumë se dy vjet pas sulmit terrorist në Banjskë, ku mbeti i vrarë një rreshter i Policisë së Kosovës, udhëheqësi i këtij grupi terrorist dhe paramilitar, Milan Radoiçiq, vazhdon të endet i lirë në Serbi dhe Beogradi zyrtar refuzon t'ia dorëzojë atë dhe grupin e tij Republikës së Kosovës, përkundër fakteve për përfshirjen e tij në sulm dhe aktakuzës së prokurorisë së Kosovës ndaj tij, ndërkohë që ai dhe grupi i tij vazhdojnë të paraqesin rrezik për sigurinë e vendit", thuhet në njoftim.

Gjatë qëndrimit disaorësh në Prishtinë, ministri Wadephul është takuar edhe ushtarë të misionit të NATO-s në Kosovë – KFOR.

Para vizitës në Prishtinë, Wadephul ka qëndruar edhe në Beograd, ku është takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, si dhe në Tiranë, Podgoricë e Sarajevë.

Turneun e tij në Ballkanin Perëndimor ministri i Jashtëm i Gjermanisë do ta përmbyllë me vizitën në Maqedoninë e Veriut.

© KOHA Ditore

KUVENDI MBAN DY SEANCA, PAS SË CILAVE VENDI MUND TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA

PDK, LDK, AAK e Nisma: S'ka votë as për buxhet, as për Qeveri

Dy seanca të ndara do të mbahen të mërkurën me kërkesë të Lëvizjes Vetëvendosje, në ditën e fundit të afatit kushtetues për krijimin e Qeverisë. Në seancën e parë ku do të synohet formimi i komisioneve që i hapin rrugë sidomos shqyrtimit të buxhetit, subjektet politike PDK, LDK, AAK dhe Nisma kanë thënë se nuk do të marrin pjesë. Të njëjtat, ndonëse kanë konfirmuar pjesëmarrjen në seancën e dytë, janë deklaruar se nuk kanë votë për Qeverinë Konjufca. Nëse dështon votimi për Qeverinë, vendi shkon në zgjedhje të parakohshme

vijon nga ballina

Pas përfundimit të kësaj seance, deputetët do të mblidhen sërish për zgjedhjen e Qeverisë. Në Lëvizjen Vetëvendosje nuk kanë treguar nëse janë siguruar votat e nevojshme për votim të suksesshëm. Për këtë refuzoi të përgjigjet edhe kryetari i kësaj partie, Albin Kurti, kur u pyet nga gazetarët.

"Më duhet të shkoj shpejt në takimin e radhës", ka thënë Kurti.

Në partitë që ishin opozitë në legjislaturën e kaluar, i kanë konfirmuar qëndrimet kundër Qeverisë Konjufca.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se Vetëvendosja nuk ka vullnet për ta bërë Qeverinë dhe se e ka zvarritur qëllimshëm procesin deri më tash.

"Qëndrimi i PDK-së është i njëjtë që kemi pasur tashmë e më shumë se tetë muaj në raport me krijimin e institucioneve. Edhe seanca e nesërme, e cila është dita e fundit juridikisht që duhet me u thirre, është vazhdimësi e orvatjes dhe lojës politike që mazhoranca e ka bërë pa vullnetin për të ndërtuar institucionet e shtetit, pra do të jetë një përsëritje e një skenari që tashmë është i njohur", ka thënë Shala.

Mospjesëmarrjen e PDK-së e konfirmoi edhe zëdhënësi i kësaj partie, Faton Abdullahu.

"Ne nesër nuk marrim pjesë në seancën e orës 11:00, vetëm në atë të orës 14:00", ka thënë ai.

Po ashtu edhe në LDK kanë deklaruar se nuk do të marrin pjesë në seancën e thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje për trajtimin e çështjes së buxhetit për vitin e ardhshëm e të disa marrëveshjeve ndërkombëtare. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij nuk bëhet pjesë e shfaqjeve parlamentare të pushtetit në ikje. Sipas tij, deputetët e LDK-së do të marrin pjesë vetëm në seancën për zgjedhjen e Qeverisë dhe se do të votojnë kundër mandatarit të LVV-së, Glauk Konjufca, të cilin e quajti kukull.

"Zvarritën tetë muaj krijimin e shumicës e formimin e institucioneve. Na i humbën edhe 15 ditë të tjera me mandatar kukull që s'bënte asnjë përpjekje për minimalisht qëverisje. Nesër, në ditën e fundit, orën e fundit, afatin e fundit, paskan thirrur dy seanca për urgjencën që e shkaktojnë vetë me vonesë... Nesër, nga ora 14:00, votojmë me bindje e krenari kundër pakicës që nuk mund të sillet si shumicë më në këtë shtet", ka thënë Abdixhiku.

Pjesëmarrjen vetëm në seancën e orës 14 e ka konfirmuar edhe zëdhënësi i AAK-së, Kushtrim Xhemaili.

Ky subjekt javën e kaluar ka dalë me qëndrim për çështjen e mandatarit.

"AAK ka mbajtur mbledhjen e Kryesisë të enjten, ku ka dalë me qëndrim të prerë, rrugëdalja e vetme nga gjendja në të cilën ndodhet vendi është shkuarja në zgjedhje të parakohshme parlamentare... Nuk ka koalicion me VV, nuk kemi votë për Konjufcën dhe askënd nga radhët e tyre", ka shkruar Xhemaili në Facebook.

As Nisma Socialdemokrate nuk do të marrë pjesë në seancën e orës 11:00.

"Këto tema nuk mund të trajtohen si dekor për fushatë dhe as si instrument i propagandës ditore. Për këto arsye, NISMA Socialdemokrate nuk do të marrë pjesë në këtë seancë të improvizuar. Ne do të mbetemi të përkushtuar ndaj zgjidhjeve që u shërbejnë qytetarëve, që rikthejnë normalitetin institucional dhe që respektojnë rendin kushtetues. Në këtë moment vendi ka nevojë për qartësi, përgjegjësi dhe veprim të matur, jo për lëvizje të nxituara me prapaskenë elektorale", thuhet në deklaratën e Nismës Socialdemokrate.

Ndaj seancës së thirrur nga Vetëvendosje për trajtimin e buxhetit kanë reaguar edhe në shoqërinë civile. Albert Krasniqi nga "Demokraci Plus" ka thënë se kjo seancë është e paligjshme dhe në kundërshtim me rendin kushtetues të vendit. Ka thënë se e vetmja zgjidhje është krijimi i një qeverie teknike me mandat të kufizuar që do të kishte vetëm një qëllim - ta nxjerrë vendin nga bllokada dhe të përgatisë zgjedhjet e ardhshme.

"Kjo seancë nuk është zgjidhje por është një manovër politike e pushtetit, të cilës i është bashkuar së fundi edhe presidentja Osmani, për të zhvendosur fajin te të tjerët për pasojat e rënda financiare me të cilat do të përballet vendi", ka thënë ai.

Seriozitetin e Vetëvendosjes për t'i trajtuar këto çështje e ka kontestuar edhe Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës.

"Së pari, duket se ka shumë pak besim që Qeveria e propozuar nesër do të sigurojë shumicën e nevojshme. Për më tepër, dështimi eventual për miratimin e pikave të nesërme do të tentohet të kapitalizohet si kartë politike gjatë fushatës së ardhshme zgjedhore. Dhe së dyti, po jepen sinjale se vendi mund të mbetet pa Qeveri të re funksionale edhe përtej muajit mars - kur çështjet buxhetore bëhen realisht emergjente", është shprehur Cakolli.

Në rast të dështimit të Konjufcës për të siguruar votat e nevojshme për Qeverinë, presidentja është e obliguar t'i shpallë zgjedhjet e parakohshme që duhet të mbahen brenda 40 ditësh nga dita e shpalljes.

Zgjedhjet për Qeverinë që synohet të formohet nesër janë mbajtur më 9 shkurt të këtij viti. Lëvizja Vetëvendosje ka dalë e para me 42.30 për qind të votave, e pasuar nga PDK-ja me 20.95, LDK-ja me 18.27 dhe AAK-Nisma me 7.8 për qind të votave.

LVV-ja ka siguruar 48 ulëse, PDK 24, LDK 20, AAK 5, Nisma 3, ndërsa Lista Serbe ka nëntë nga dhjetë ulëset e garantuara për minoritetin serb. Një ulëse nga komuniteti serb e ka partia e Nenad Rashiqit, ndërsa dhjetë ulëset e tjera nga 120 sa ka gjithsej Kuvendi i kanë fituar përfaqësuesit e minoriteteve të tjera.


© KOHA Ditore

NË BEOGRAD ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E SIGURISË

Evropa pa mekanizëm të përbashkët për t'u përballur me agresionin hibrid rus

Sulmet hibride, përfshirë sulmet ajrore ndaj infrastrukturës kritike, sulmet kibernetike dhe manipulimet në rrjetet sociale, po minojnë institucionet, po polarizojnë shoqëritë dhe po krijojnë terren të përshtatshëm për përshkallëzime të reja, kanë deklaruar zyrtarë nga vende të BE-së në Konferencën e Sigurisë, në Beograd, të martën

Fitim Gashi



BEOGRAD, 18 NËNTOR - Evropa Lindore dhe Juglindore po përballen me presion të shumëfishtë nga lufta hibride ruse, u tha të martën në Konferencën e Sigurisë në Beograd.

Përfaqësues të vendeve evropiane, pjesëmarrës në konferencë, paralajmëruan se Evropa Lindore dhe Juglindore po përballen me presion të shumëfishtë nga lufta hibride ruse, e cila po e transformon mënyrën se si shtetet e rajonit e konceptojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë demokratike.

Sulmet me dronë e raketa, fushatat e sofistikuara të dezinformimit dhe ndërhyrjet në zgjedhje, sipas politikanëve nga vendet e BE-së, bëjnë që rajoni të futet në një periudhë të tensionuar, ku "situata duket si në prag të luftës".

Sipas tyre, këto kërcënime nuk qëndrojnë të izoluara. Përkundrazi, ato ndërthuren me dobësitë e brendshme të vendeve evropiane dhe përçarjet politike, duke rritur rrezikun për stabilitetin e kontinentit. Operacionet hibride po shihen gjithnjë e më shumë si mjete për të destabilizuar qeveritë, për të minuar integrimin euroatlantik dhe për të nxitur tendenca autoritare.

Në konferencë u theksua nevoja urgjente që Perëndimi - BE, NATO dhe partnerët transatlantikë - të hartojnë një strategji të unifikuar kundër këtyre kërcënimeve.

Thomas Röwekamp, anëtar i Bundestagut gjerman dhe kryetar i Komitetit për Mbrojtje, paralajmëroi se Evropa ende nuk e ka gjetur mekanizmin e duhur të përbashkët për t'u përballur me agresionin hibrid rus.

"Problemi kryesor është mungesa e pajtimit kundër kërcënimeve të tilla. Jemi viktima të sulmeve të përditshme të Rusisë, në forma të ndryshme – me dronë, në porte, në infrastrukturën e të dhënave. Nuk jemi në luftë, por ndodhemi mes luftës dhe paqes. Duhet shikim i përbashkët përballë kërcënimit të Rusisë", tha ai.

Röwekamp shtoi se Gjermania ka ende vendime të mëdha për të marrë në nivel kombëtar dhe se kapacitetet aktuale nuk janë të mjaftueshme për t'u përballur me kërcënimet hibride.

"Duhet më shumë zgjidhje evropiane dhe të NATO-s dhe t'i bashkojmë kapacitetet për t'u përballur me kërcënimet", ka thënë ai.

Frédéric Petit, deputet i Parlamentit të Francës, paralajmëroi se Rusia përdor justifikime propagandistike për ndërhyrjet në rajon, ndërsa vendet evropiane duhet të fokusohen në forcimin e mbrojtjes demokratike.

"Kemi luftë hibride, prandaj duhet mbrojtje hibride. Ajo që të rinjtë në Serbi po bëjnë sot është mbrojtje - ata po luftojnë me mjete të ndryshme dhe duhet të jetë shembull për të gjithë", ka potencuar Petit.

Ai shtoi se Perëndimi ka qenë i gatshëm të ndihmojë Ukrainën ushtarakisht, dhe se e njëjta qasje e koordinuar duhet të zbatohet kundër kërcënimeve joushtarake.

"Duhet gatishmëri për bashkëpunim. Duhet të mësojmë edhe nga gabimet tona; i kemi centralizuar tepër gjërat, që krijon vështirësi në adresimin e sfidave të përbashkëta".

Nga Moldavia, Mihaela Siritanu, eksperte e politikave publike, përshkroi ndërhyrjet ruse, të cilat ndodhin paralelisht në shumë fronte.

"Sa herë i afrohemi BE-së, shfaqen probleme që prekin jetët e qytetarëve - ndërprerje të rrymës, krizë ekonomike - për të rritur frustrimin qytetar. Ky është ndikimi rus. Moldavia u është bashkuar sanksioneve kundër Rusisë, por ata shpenzojnë miliona euro për të ndikuar zgjedhjet dhe për të blerë aktivistë", potencoi ajo.

Tutje Siritanu paralajmëroi për rritje të manipulimeve në internet dhe blerjes së votave përmes kanaleve të fshehta financiare.

"Moldavia u është bashkuar sanksioneve kundër Rusisë, por ata shpenzojnë miliona euro për të ndikuar zgjedhjet dhe për të blerë aktivistë", u shpreh ajo.

Ish-kryeministri bullgar, Kiril Petkov, ofroi një shembull konkret të mënyrës se si Rusia operon brenda një shteti anëtar të BE-së.

"Politikanë të korruptuar që flasin pro-Evropës, ndërhyrje në drejtësi, në shërbimet e sigurisë, në kishë - të gjitha të nxitura nga Rusia", ka deklaruar Petkov.

Petkov kujtoi se gjatë mandatit të tij u arrestuan dhe dëbuan disa agjentë rusë, ndërsa oligarkët lokalë të lidhur me Moskën vazhdojnë të kontrollojnë media dhe parti politike.

Enrico Borghi, president i Institutit të Demokratëve Evropianë, vuri në dukje se të hënën, për herë të parë, Këshilli i Lartë i Mbrojtjes u mblodh për të diskutuar çështjen e kërcënimeve hibride.

"Pavarësisht një peizazhi politik të karakterizuar nga përçarja, Senati italian së fundi arriti një konsensus mbi një temë të promovuar si nga forcat e shumicës ashtu edhe nga ato të opozitës dhe të njohur zyrtarisht si e nevojshme për t'u adresuar luftërave hibride", ka thënë ai.

Borghi theksoi se avancimi i teknologjisë përballë këtyre kërcënimeve është shumë i rëndësishëm.

© KOHA Ditore

BANORËT SERBË NË VERI TË KOSOVËS NDIHEN TË MASHTRUAR NGA POLITIKA E LISTËS SERBE DHE E SERBISË

Pasoja për serbët në veri, edhe tre vjet pas largimit nga institucionet

Tre vjet pas largimit të serbëve nga institucionet e Kosovës, vazhdojnë akuzat se Lista Serbe dhe Beogradi po shantazhojnë dhe ndëshkojnë qytetarët që nuk i mbështesin politikat e tyre. Shumë ish-punonjës që dhanë dorëheqje në vitin 2022, mbetën pa pagat e premtuara nga Serbia dhe pa mundësi rikthimi në institucionet e Kosovës. Ndërkohë Beogradi ka hapur konkurse të reja punësimi gjatë fushatave zgjedhore në Kosovë - gjë të cilën autoritetet kosovare e kanë vlerësuar si ndërhyrje në procesin zgjedhor

MITROVICË, 18 NËNTOR - Tre vjet pasi serbët në veri të Kosovës u larguan nga institucionet e vendit, vazhdojnë akuzat kundër Listës Serbe dhe Beogradit zyrtar se populli është "mashtruar" dhe se ata po "hakmerren" dhe "shantazhojnë" këdo që kundërshton politikat e tyre.

Këto ankesa filluan të dalin në publik disa muaj pasi disa qindra punonjës të policisë, drejtësisë dhe administratës lokale në veri të Kosovës dhanë dorëheqje, në fillim të nëntorit të vitit 2022, për shkak të insistimit të Qeverisë së Kosovës për t'i zëvendësuar targat serbe të makinave me targa të Kosovës.

Largimin nga institucionet e Kosovës e inicioi Lista Serbe, ndërsa Beogradi zyrtar - që e mbështet partinë më të madhe të serbëve në Kosovë - e përkrahu këtë vendim.

Punonjësve që dhanë dorëheqje u ofruan kontrata të përkohshme me pagë nga buxheti i Serbisë. Megjithatë, shumë prej tyre mbetën pa këto të ardhura dhe pa mundësinë për t'u rikthyer në vendet e tyre të punës.

Njëri prej tyre është edhe Sllobodan Rashkoviq nga fshati Dren i Zubin-Potokut në veri të Kosovës, i cili thotë se tash e dy muaj nuk e ka marrë pagën nga buxheti i Serbisë prej 66.000 dinarësh apo rreth 550 euro, si kompensim për dorëheqjen që ka dhënë tre vjet më parë nga Policia e Kosovës.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai thotë se ekzistenca e tij është e kërcënuar, pasi këto të ardhura i kanë shërbyer për të mbajtur familjen. Gruaja e tij është e papunë, ndërsa katër fëmijët janë të mitur.

"Nuk kemi më asnjë të ardhur"

Rashkoviqi beson se të ardhurat që merrte nga Serbia i janë hequr, sepse ai nuk e mbështet politikën e Listës Serbe, ndërsa bashkëshortja e tij, Bojana, në zgjedhjet lokale të mbajtura së voni në Kosovë ka qenë kandidate për asambliste në Kuvendin e Komunës së Zubin-Potokut nga radhët e Aleancës së Kosovës.

Rashkoviqi thotë se para tre vjetësh ka dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës, pas 20 vjetësh përvojë pune, nga bindja se duhej të shprehte solidaritet me bashkëkombësit e tij.

Nga perspektiva e sotme, ai mendon se ka marrë një vendim të gabuar. Po të ishte e mundur, thotë se do të kthehej menjëherë në Policinë e Kosovës.

Në shtator të vitit të kaluar, ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, tani në detyrë, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se ligjet nuk lejojnë që policët që kanë dhënë dorëheqje të rikthehen në punë. Ai ka thënë se organet kompetente kanë pritur 30 ditë që zyrtarët policorë t'i rishqyrtojnë vendimet e tyre, por kjo nuk ka ndodhur.

Ndërkohë Policia e Kosovës ka shpallur disa herë konkurse për t'i plotësuar vendet e punës në komunat në veri të Kosovës.

Rashkoviqi thotë se Serbia, përveç kompensimit financiar, i ka hequr edhe shtesat për fëmijë që merrte nga buxheti i saj.

"Nuk kemi më asnjë të ardhur", thotë ai, duke shtuar se nuk ka marrë asnjë arsyetim apo vendim, por as nuk është ankuar diku, sepse "nuk ka te kush".

"Te kush të drejtohem kur ata [Lista Serbe dhe Beogradi] ma kanë hequr rrogën? Nuk e di çfarë të bëj", shprehet ai.

Angazhimi politik si arsye për ndalimin e të ardhurave

Bashkëshortja e Rashkoviqit, Bojana, thotë se është angazhuar politikisht kundër Listës Serbe sepse, sipas saj, pozita e komunitetit serb në Kosovë është përkeqësuar dhe se punë gjejnë vetëm "personat e përshtatshëm".

"Ata mendojnë se vetëm ai që mendon si ata [Lista Serbe] mund të ketë punë e gjithçka tjetër. Kush mendon ndryshe, nuk ka asnjë të drejtë. Për çdo gjë vendosin ata", thotë Bojana.

Radio Evropa e Lirë kërkoi koment nga Lista Serbe për akuzat e familjes Rashkoviq, por nuk mori asnjë përgjigje.

As Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë nuk iu përgjigj pyetjes se përse u hiqen kompensimet financiare nga buxheti i Serbisë personave që kanë lënë institucionet e Kosovës.

Përndryshe, gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale në Kosovë, Ivan Petroviq dhe Ivan Ristiq nga Ranillugu - komunë me shumicë serbe pranë Gjilanit - hynë në grevë urie, pasi morën vendimin për shkarkim nga organi i përkohshëm komunal i Kamenicës, që funksionon në kuadër të sistemit serb.

Petroviqi ishte kandidat për kryetar dhe asamblist nga Lëvizja Popullore Serbe në Komunën e Ranillugut, ndërsa Ristiqi ishte kandidat për asamblist nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. (REL)

Ata i thanë Radios Evropa e Lirë më 17 nëntor se kanë paditur Komunën e Kamenicës - që funksionon sipas sistemit serb - në Gjykatën Administrative në Beograd.

Edhe Millosh Kovaçeviq nga fshati Banjë në Komunën e Skenderajt i tha Radios Evropa e Lirë në shkurt të këtij viti se është larguar nga organi i përkohshëm komunal që funksionon brenda sistemit serb, vetëm se në zgjedhjet parlamentare është angazhuar politikisht kundër Listës Serbe.

Më 16 nëntor Kovaçeviq tha se është ende pa punë dhe se ndodhet buzë mbijetesës.

Raste të ngjashme janë evidentuar edhe gjatë zgjedhjeve të mëhershme në Kosovë, kur pjesëtarë të komunitetit serb që nuk mbështetnin Listën Serbe merrnin vendime për shkarkim nga puna.

Nga ana tjetër, Beogradi zyrtar, gjatë fushatave zgjedhore në Kosovë, ka hapur shpesh konkurse për vende të reja pune në institucionet e tij.

Kjo ka ndodhur edhe në zgjedhjet e fundit lokale më 12 tetor, kur Ministria e Shëndetësisë e Serbisë ka shpallur konkurs për 400 vende të reja pune në institucionet e saj në Kosovë - gjë të cilën autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar si "ndërhyrje në procesin zgjedhor".

NË HAGË KA VAZHDUAR DËSHMIA E GJENERALIT TË NATO-S, WESLEY CLARK

Clark: Në UÇK s'pati strukturë komanduese dhe kontrolli

Në përgjigje të pyetjeve të mbrojtjes së Hashim Thaçit, në ditën e dytë të dëshmisë së tij, Wesley Clark tha se në UÇK pati figura të fuqishme - si komandantë zonash, që nuk i jepnin llogari askujt. Sipas gjeneralit që drejtoi NATO-n gjatë kohës së luftës në Kosovë, komandantët e zonave ishin persona që luftonin për jetën e tyre dhe këtë qëndrim e mbajtën edhe pas fushatës ajrore

Ardit Kika

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s për Evropë, Wesley Clark, ka deklaruar para Dhomave të Specializuara në Hagë se në UÇK nuk pati strukturë komanduese dhe as strukturë kontrolli.

Tek iu përgjigj pyetjeve të mbrojtjes së Hashim Thaçit, në ditën e dytë të dëshmisë së tij, Clark tha se në UÇK pati figura të fuqishme - si komandantë zonash, që nuk i jepnin llogari askujt.

Si shembull e përmendi Ramush Haradinajn që udhëhoqi me Zonën Operative të Dukagjinit gjatë luftës në Kosovë.

"Dua të them dicka. Ramush Haradinaj që ka qenë komandant i fuqishëm, ishte më i pavarur si natyrë... Pikërisht kjo është përshtypja ime dhe prandaj dola në këtë përfundim sa i përket komandës dhe kontrollit – se si ka funksionuar komanda dhe kontrolli në UÇK. Ishin personalitete të forta, persona që kanë rrezikuar jetën. Jeta e familjeve të tyre varej prej vendimeve të tyre. Këta nuk ishin vartës të mirëfilltë. Nuk ekzistonte strukturë komande dhe kontrolli. Ishin persona që luftonin për jetën e tyre gjatë fushatës së NATO-s dhe këtë qëndrim e mbajtën edhe pas fushatës ajrore. Prandaj, Jackson e pati të vështirë me këta persona, me këta individë, andaj kishte akte hakmarrëse, kështu që persona të caktuar mund të kenë kryer akte dhune ndaj serbëve", tha Clark.

Gjenerali Clark u shpreh se Thaçi ishte më i shfaqur publikisht e më i artikuluar dhe se roli i tij i ngjante atij të zyrtarit ndërlidhës.



Prokurori i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Matthew Halling, e ballafaqoi dëshmitarin me një libër të gjeneralit Mike Jackson, ku është përshkruar takimi kur Thaçi i bërtiti gjeneralit britanik.

"Jackson flet për momentet para se ju t'i bashkoheshit takimit dhe këtu thuhet. Negociatat u bënë shumë të tensionuara përpara se ju të mbërrinit në takim. Jackson më tej thotë: Ne mbërritëm te D+89-a, ndërkohë që Thaçi na tha 'askush nuk luan lojëra me ÜÇK-në', na bërtiti duke e thënë këtë gjë. 'Në qoftë se ju mendoni se mund të na jepni udhëzime, atëherë e keni gabim, do t'ju vijë keq për këtë'. Dëshmitar a keni qenë në dijeni për këtë", pyeti Halling.

Clarku u përgjigj se e ka përshtypjen se Jacksoni ma ka thënë këtë. Dëshmitari theksoi kjo ndodhi kur po negociohej çarmatosja e UÇK-së. I pyetur nga prokurori se a kishte Thaçi rol ndryshe nga liderët ushtarakë, ai tha se i dukej se po.

"Duket sikur është kështu... Në momentin kur unë u ktheva, unë u mundova të sigurohesha që nuk kishte më një asociim ushtarak pas ndërhyrjes. Ndërkohë, ajo për të cilën po flasim këtu janë thjesht hollësitë se si janë zhvilluar këto bisedime. Sigurisht që ka pasur shumë inat, sigurisht që ka pasur shumë fërkime dhe sigurisht që janë bërë shumë deklarata", tha Clark.

Dëshmia e Clarkut vazhdon edhe të mërkurën.

Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli e Jakup Krasniqi, si dhe ish-shefi i deputetëve të Vetëvendosjes Rexhep Selimi, akuzohen për ndërmarrje të përbashkët kriminale lidhur me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Në bazë të aktakuzës së ZPS-së e publikuar në shkurt të vitit 2023, Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi akuzohen për ndërmarrje të përbashkët kriminale lidhur me rreth 100 vrasje, pastaj për tortura e trajtim mizor në rreth 40 qendra ndalimi gjatë periudhës 1998-1999.

ZPS-ja pretendon se kryen ndërmarrje të përbashkët kriminale që ndërlidhen me gjashtë akuza për krime lufte, si: Përndjekje (Pika 1), burgosje (Pika 2), akte të tjera çnjerëzore (Pika 4), torturë (Pika 6), vrasje e paligjshme (Pika 8), zhdukje me dhunë (Pika 10) si dhe katër akuza për krime kundër njerëzimit, përfshirë këtu arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar (Pika 3), trajtim mizor (Pika 5), torturë (Pika 7) dhe vrasje e paligjshme (Pika 9).

Shumica e viktimave të krimeve sipas ZPS-së janë shqiptarë, civilë dhe pjesëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Sipas ZPS-së, të akuzuarit kanë qenë në dijeni apo është dashur të jenë në dijeni shkaku i pozitave udhëheqëse në shtab të përgjithshëm, lidhur me pretendimet për krimet që janë kryer dhe kanë pasur qëllim që ta marrin pushtetin në Kosovë përmes tyre.

Ish-drejtuesit e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së i kanë mohuar të gjitha këto akuza. Ata kanë thënë se UÇK-ja nuk kishte hierarki të tillë, meqë peshën e kishin komandantët e zonave dhe se kishte për qëllim të luftonte Serbinë e jo civilët.

© KOHA Ditore

BIZNESET NUK PAJTOHEN ME VENDIMIN PËR TREG TË HAPUR TË ENERGJISË

ZRRE-ja e OEK-u me interpretime të ndryshme për vendimin e Supremes

Oda Ekonomike e Kosovës ka kërkuar nga ZRRE-ja zbatimin e vendimit të Supremes lidhur me daljen në treg të hapur të energjisë të rreth 1.300 bizneseve. Sipas kësaj organizate, kjo nënkupton kthimin në pikën zero të këtij procesi. Por në ZRRE thonë se vendimi i saj nuk është i bazuar në dispozitat e shfuqizuara

Sanie Jusufi

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Vendimi i Gjykatës Supreme lidhur me padinë për daljen në treg të hapur të energjisë të rreth 1.300 bizneseve është interpretuar në mënyra të ndryshme nga Oda Ekonomike e Kosovës si paditëse dhe nga Zyra e Rregullatorit për Energji si e paditur.

Derisa në OEK kanë thënë se vendimi i Supremes e kthen në pikën zero procesin e daljes në treg të hapur të energjisë dhe kërkuan që të zbatohet aktgjykimi, në ZRRE kanë deklaruar të kundërtën.

"Oda Ekonomike do ta monitorojë nga afër implementimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ta kthejë gjendjen në pikën zero, sepse e ka kthy Gjykata, sepse nuk është se po mbetet në vullnetin e ZRRE-së në pikën zero dhe të fillojë të përgatisë bazën ligjore për të krijuar sigurinë juridike dhe ekonomike që janë parime bazë dhe kushtetuese te ne. Nëse nuk ndodh kjo, Oda Ekonomike do të marrë veprime të tjera civile dhe penale, sepse në këtë rast edhe Prokuroria Speciale do të duhej ex-officio me fillu procedurën, pasi në mënyrë të kundërligjshme iu keni shkaktuar dëm bizneseve", ka thënë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës.

Supremja të hënën ka shfuqizuar nene të udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë, që kanë të bëjnë me kriteret e daljes në treg të hapur.

Por, në ZRRE kanë thënë se vendimi i saj për tarifa me pakicë për vitin 2025 nuk është i bazuar në dispozitat e shfuqizuara të udhëzuesit.

"Gjykata ka vërtetuar se e drejta për furnizim me tarifa të rregulluara të energjisë elektrike u takon vetëm konsumatorëve të kualifikuar për Shërbim Universal, që është në përputhje të plotë me Vendimin e Bordit të ZRRE-së për tarifat me pakicë për vitin 2025 dhe Direktivën për Energji Elektrike të Bashkimit Evropian 2009/72/EC. ZRRE, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka për obligim të përcaktojë tarifa të energjisë elektrike me pakicë vetëm për konsumatorët e energjisë elektrike që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe jo për konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e furnizimit me shërbim universal", thuhet në njoftimin e ZRRE-së.

E avokati Ekrem Hoxha, që ka bërë padinë në emër të OEK-ut, është shprehur se asnjë shtet i rajonit që mbështetet në direktivat e BE-së nuk ka zgjedhur modelin që po e ndjek Kosova.

"Kosova është vendi i vetëm, i cili ka përvetësuar kriterin e ndarjes së qarkullimit mbi 10 milionë dhe mbi 50 punëtorë. Asnjë shtet i rajonit nuk e ka këtë, as vendet e BE-së, por shtetet e BE-së e bëjnë liberalizimin mbi bazën e volumit të konsumit të energjisë elektrike. Direktiva e BE-së thotë se në bazë të kapacitetit dhe konsumit, jo në bazë të kategorizimit si NMV. NMV-të janë vetëm për kategorizim për çështje tatimore dhe përfitim të granteve nga shtetet", ka thënë Hoxha.

Dalja e bizneseve në treg të hapur është atakuar edhe në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Demokratike e Kosovës në fund të muajit gusht.

Nga kjo gjykatë kanë thënë për KOHËN se lënda është në proceduré të shqyrtimit.

"Vendimi do të publikohet pasi që të shqyrtohen të gjitha aspektet kushtetuese të pretendimeve të bëra në kërkesë nga pala parashtruese, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës", thuhet në përgjigjen e Kushtetueses.

Zyra e Rregullatorit për Energji në mars të këtij viti ka njoftuar për dal-



jen e detyrueshme në treg të lirë të energjisë të rreth 1.300 bizneseve, duke detyruar që të zgjedhin vetë furnizuesin.

Vendimi ka prekur bizneset me mbi 10 milionë euro qarkullim ose me mbi 50 punëtorë.

© KOHA Ditore

SHUMË KOMUNA TË MARTËN JANË PËRBALLUR ME VËSHTIRËSI TË SHUMTA

Shirat e dendura shkaktuan edhe përmbytje

Kosova është goditur nga reshje të mëdha shiu, të cilat kanë shkaktuar vërshime. Disa zona janë përmbytur, përfshirë edhe lagje të kryeqytetit. Edhe qarkullimi në magjistrale e rrugë lokale është vështirësuar. Por, në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave kanë thënë se situata është nën kontroll

Donisa Fazliu

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Reshjet me intensitet të lartë të shiut kanë shkaktuar vërshime gjithandej Kosovës.

Ato kanë përfshirë edhe Prishtinën.

Në lagjen "Kodra e Trimave" janë përmbytur edhe shtëpi, e banorët ankohen se autoritetet nuk kanë ndërmarrë masa.

"Gjendja po shihet vetë, gjendja reale qysh është. Prej 2023-s, Komuna e Prishtinës nuk ka ndërmarrë diçka dhe për fat të keq asnjëherë nuk ka ardhë diçka me bë intervenim këtu. Problem më i madh është se këtu bllokohet kanalizimi e ne kemi problem me shtëpitë tona se na vjen kanalizimi brenda", ka thënë Ardian Krasniqi, qytetar.


Krasniqi është ankuar se autoritetet e komunës nuk u janë përgjigjur thirrjeve për ndihme gjatë të martës.

"Prej orës 07:30 Komunën e Prishtinës i kemi thirrë, për fat të keq asnjë zyrtar i komunës nuk ka qenë në vendin e ngjarjes", ka thënë ai.

Si shkak i vërshimeve, është bllokuar edhe një rrugë në lagjen "Arbëria". Ecjen në trotuar, qytetarët e patën të pamundur. Andaj kalimin e rrugës u detyruan ta bënin nëpër ujë.

Por, disa prej tyre u detyruan të kthehen mbrapshtë.

"Provova me kalu duke u kthy



prej punës, provova me kalu rrugën, por që nuk pata mundësi dhe po kthehem prapë mbrapa. Këtu çka po mendoj pse gjithë këto vërshime këtu është për shkak të punimeve jo të mira që janë bërë", ka thënë Edina Krasniqi, qytetare.

Gjatë ditës kanë intervenuar edhe ekipet e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave.

E drejtori për siguri dhe emergjenca në Komunën e Prishtinës, Lulzim Fushtica, ka deklaruar se me të marrë informacion për vërshime, kanë filluar edhe përgatitjet.

"Ne që dy ditë kemi filluar përgatitje dhe tani gjendemi në qendrën operative të qytetit ku kemi aktivizuar edhe shtabin emergjent. Jemi të përgatitur për çdo situatë që mund të godet kryeqytetin. Gjitha ekipet janë në terren, kemi raste dhe sipas informatave që kemi nga Instituti reshjet do të vazhdojnë deri pas mesnatës", ka thënë Fushtica.

Përveç kryeqytetit, me vërshime janë përballur edhe komuna të tjera.

Kolona të gjata janë shkaktuar në disa segmente të magjistraleve.

Është raportuar për vërshime edhe në Gjilan, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Novobërdë e Rahovec.

E në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent kanë thënë se është ngritur niveli i gatishmërisë dhe se situata është nën kontroll.

Priten probleme me ujin e pijshëm për shkak të reshjeve të shiut

Zëdhënësja e KRU "Prishtina", Arjeta Mjeku, ka paralajmëruar mundësinë e problemeve me ujin e pijshëm në zonat të cilat furnizohen nga kanali Ibër-Lepenc përmes impiantit Shkabaj. Ajo të martën në emisionin "60 Minuta" të KTV-së ka thënë se aktualisht gjendja është stabile.

"Gjendja aktuale me ujë të pijshëm vazhdon të jetë stabile edhe pse në bazë të statistikave që i kemi në impiantin e trajtimit të ujit në Shkabaj, uji që e marrim nga 'Ibër-Lepenci' pritet të ketë shpejt turbullira të ujit. Njëherë përnjëherë nuk kemi ndonjë shqetësim, por bazuar në intensitetin e reshjeve priten turbullira në orët e mbrëmjes. Zonat që preken janë Fushë-Kosova, një pjesë e Obiliqit, Drenasit dhe Prishtinës", ka thënë Mjeku.

TË MARTËN NË KRYEQYTET NUK ËSHTË ZHVILLUAR PROCESI MËSIMOR ME VENDIM TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Paralajmërimi për vërshime pezullon mësimin në Prishtinë, ministria kërkon kompensim të orëve

Paralajmërimi për vërshime ka ndikuar në pezullimin e procesit mësimor nëpër shkolla të Prishtinës. Derisa nxënës të ndërresës së paradites mbajtën mësim me orë të shkurtuara, për ata të pasdites e marta qe ditë pushimi. Vendimi për këtë, sipas Drejtorisë së Arsimit, u mor bazuar në rekomandimin e Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca. Ministria e Arsimit ka kërkuar kompensim të orëve

Ardona Popova

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Pak minuta pasi nxënës të ndërresës së paradites e nisën orën e parë mësimore të martën, ata u njoftuan se shkaku i kushteve atmosferike dhe paralajmërimit për vërshime mësimi është pezulluar.

Procesi mësimor në të gjitha shkollat e kryeqytetit është pezulluar për nxënësit e ciklit të ulët, ndërsa ata të ciklit të lartë i mbajtën vetëm dy orët e para.

Drejtoresha e shkollës "Meto Bajraktari", Kreshnike Ademi, ka thënë se në këtë institucion arsimor nuk ka pasur ndonjëherë vërshime, porse nxënësit janë liruar bazuar në vendimin e Drejtorisë së Arsimit.

"Shkolla "Meto Bajraktari" ka një pozitë të mire dhe në vitet paraprake nuk kemi pasur ndonjë vërshim ose vështirësi gjatë reshjeve të shiut përderisa e ka vlerësuar drejtoria e arsimit dhe drejtoria e emergjencave, ne e kemi respektuar vendimin tyre dhe kemi bërë shkurtimin e orarit për ciklin e lartë dhe pezullimin e mësimit për ciklin e ulët", ka thënë drejtoresha Ademi.

Drejtori Samir Shahini ka thënë se paralajmërimet për mundësinë e vërshimeve në kryeqytet dhe në vendet tjera të Kosovës kanë bërë që Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca në Prishtinë, së bashku me Drejtorinë e Arsimit, të vendosin që të martën procesi mësimor të mos zhvillohej.

"Duke qenë që në mëngjes stuhia veç sa nisi me u përkeqësu në atë masë sa ka qenë në të vërtet e rrezikshme edhe për ecjen në rrugë, edhe për mbajtjen e procesit mësimor, për problemet që mund të kemi edhe me energji elektrike, është marrë rekomandim nga drejtoria për siguri dhe emergjenca që të ndërpritet procesi mësimor", ka thënë Shahini.

E gjatë orëve të pasdites të së martës, Shahini ka njoftuar se të mërkurën procesi mësimor do të zhvillohet normalisht në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të kryeqytetit.

"Bazuar në vlerësimin e shtabit emergjent, informacionet e fundit nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe koordinimin me drejtorité përkatëse të kryeqytetit, është konstatuar se situata është e qëndrueshme për zhvillim të rregullt të mësimit. Intensiteti i reshjeve gjatë natës pritet të bie dukshëm sipas vlerësimeve të fundit të IHMK-së, ndërsa ekipet emergjente janë në terren dhe po sigurohen që infrastruktura shkollore të jetë plotësisht e gatshme" ka thënë ai.

E të mërkurën reshjet e shiut por me intensitet më të ulët pritet të vazhdojnë deri në mesditë. Hidrologu në Institutin Hidrometeorologjik, Bashkim Kastrati, ka thënë se ndonëse Prishtina nuk njihet për vërshime të mëdha, rreziku për përmbytje ekziston në rastet kur reshjet me intensitet të lartë zgjasin për kohë më të gjatë.

"Nëse mesatarisht brenda tri orëve, në çdo vend të Kosovës, por sidomos nëpër zonat urbane, bie sasia e reshjeve mbi 40 mm, atëherë është e pashmangshme d.m.th. në pjesë të caktuara të atij vendbanimi apo atij lokacioni, në këtë rast të Prishtinës, mund të ketë vërshime urbane", ka thënë Kastrati

Pos në Prishtinë, reshjet e dendura të shiut shkaktuan vërshime në shumë zona të Kosovës porse, sipas Ministrisë së Arsimit, mësimi në këto pjesë është zhvilluar normalisht.

"Nga informatat e mbledhura nga sektorët rajonalë të Inspektoratit të Arsimit, rezulton se në të gjitha shkollat në Kosovë mësimi është zhvilluar normalisht, edhe në shkollat që punojnë me dy ndërresa, me përjashtim të shkollave në Komunën e Prishtinës. Inspektorati i Arsimit, bazuar në kompetencat e tij ligjore, do të monitorojë dhe do të sigurohet që të gjitha orët e humbura të procesit mësimor të ditës së sotme të zëvendësohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Arsimit.

Në Institutin Hidrometeorologjik kanë paralajmëruar nga e hëna për rrezik të vërshimeve në disa lokalitete në Kosovë gjatë së martës e së mërkurës, si pasojë e reshjeve që nisën në orët e vona të së hënës.

EKSPERTË NDËRKOMBËTARË ALARMOJNË PËR RRITJEN E VARËSISË SË FËMIJËVE NGA CIGARET VAPE

OBSH-ja u kërkon shteteve t'i shtrëngojnë masat ndaj cigareve elektronike

Në Gjenevë, Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka nisur konferencën gjashtë ditore për kontrollin e duhanit. Në të u alarmua për përdorimin e madh të cigareve elektronike nga fëmijët dhe për varësinë që ato shkaktojnë tek të rinjtë

vijon nga ballina

Drejtoresha e përgjithshme e shëndetit dhe sigurisë ushqimore në Komisionin Evropian, Sandra Galina, tha se përballja me ngjyra dhe aroma të ndryshme të VAPE është sfiduese.

"Aromat kanë luajtur një rol jashtëzakonisht të madh në tërheqjen e fëmijëve. Janë hapi i parë drejt nisjes së duhanit ose nikotinës. Është shumë e vështirë kur përballesh me produkte të ndezura, shumëngjyrëshe, dhe me aromat e tyre të këndshme. Duhanpirësit e vjetër thonë: "po përdor cigaret elektronike" për të lënë duhanin por shpesh përfundojnë duke i përdorur krahas produkteve me nikotinë ose krahas duhanit. Dhe këtu qëndron sfida", ka thënë Galina.

Ajo tregoj edhe masat e ndërmarra kundër cigareve elektronike.

"Ne kemi vendosur kufizime të shumta për reklamimin dhe promovimin e tyre, kemi ndaluar shumë forma të promovimit. Ishte qëllimi fillestar i yni që të reduktonim funksionin e marketingut në mendjen e atyre që synohen, sidomos të rinjve, që mund të joshen lehtë. Po ashtu, jemi në proces të përditësimit të direktivës së taksimit të duhanit, me synimin të vendosim norma minimale të akcizës për duhanin e ngrohur, lëngjet e cigareve elektronike dhe produktet e tjera me nikotinë", ka bërë të ditur Galina.

Në konferencë, drejtori i përgjithshëm i OBSH-së, u bëri apel shteteve të shtrëngojnë masat në raport me cigaret elektronike.

"Ne u bëjmë thirrje të gjitha vendeve të rregullojnë të gjitha produktet e nikotinës – cigaret elektronike, produktet e duhanit të ngrohur, qeset e nikotinës, të paktën po aq rreptësisht sa rregullojnë produktet tradicionale të duhanit. Disa vende madje i kanë ndaluar plotësisht", ka thënë Ghebreyesus. "Gjithashtu u bëjmë thirrje qeverive të zgjerojnë mbështetjen për metodat e provuara të lënies së duhanit, përfshirë këshillimin dhe terapitë e mirituara të zëvendësimit të nikotinës. Vitin e kaluar, OBSH-ja publikoi udhëzime të reja klinike për trajtimin e varësisë nga duhani, dhe i inkurajojmë të gjitha vendet t'i zbatojnë ato".

Në Gjenevë u mbajt edhe tryeza diskutimi nga organizata "Campaign for Tobacco-Free Kids", në të cilën ekspertë shëndetësorë folën edhe për varësinë që shkaktojnë nikotina e cila gjetet në cigaret elektronike.

Ghazi Zaatari, profesor dhe kryetar i Departamentit të Patologjisë dhe Mjekësisë Laboratorike në Universitetin Amerikan të Bejrutit, tha se këto produkte janë larg të qenit të padëmshme.

"Ato përmbajnë toksina dhe narativa që ato ndihmojnë të hiqni dorë nga duhani është larg të qenit e vërtetë. Janë bërë disa studime që tregojnë se ato nuk ndihmojnë njerëzit të heqin dorë, ka pasur studime në mbarë botën në disa popullata", ka thënë Zaatari. "Nikotina, si substancë kimike, nuk po flas për produktet e nikotinës, nikotina është substanca adiktive. Një ekspozim ndonjëherë mjaften për ta kthyer këtë person në përdorues të gjatë të produktit".

Punimet e konferencës do të vazhdojnë deri më 22 nëntor me tema të ndryshme.

PLANI I PAQES

Këshilli i Sigurimit miraton Rezolutën e ndërmjetësuar nga SHBA-ja për Gazën

Propozimet amerikane për paqe në Gazë kanë marrë dritën e gjelbër në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në atë që hapë rrugën për vendosjen e një force ndërkombëtare stabilizuese dhe për procesin drejt shtetësisë palestineze. Rezoluta u mbështet nga Izraeli dhe Autoriteti Palestinez, por u kundërshtua nga Hamasi. Ajo parashikon bashkëpunim mes forcave ndërkombëtare, të Izraelit, të Egjiptit dhe një policie të re palestineze për çarmatosjen e grupeve militante dhe për garantimin e sigurisë në rajon



NEW YORK, 18 NËNTOR (BBC/AP) - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara i ka miratuar propozimet e paraqitura nga presidenti amerikan, Donald Trump, për paqe të qëndrueshme në Gazë, e në të cilën përfshihen dislokimi i një force ndërkombëtare stabilizuese dhe hapjen e rrugës për krijimin e shtetit palestinez.

Rezoluta u miratua me 13 vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime, nga Kina dhe Rusia.

Tel-Avivi zyrtar e mirëpriti miratimin e propozimeve nga OKB-ja. Presidenti izraelit, Isaac Herzog, e quajti moment historik.

"Kjo rezolutë është shumë e rëndësishme ngase flet për rindërtimin e Gazës dhe për një forcë ndërkombëtare që do t'i largojë militantët e Hamasit nga Gaza. Me ndihmën e agjencive dhe institucioneve ndërkombëtare, mund t'i ofrojmë popullit të Gazës një të ardhme më të mirë. Ky është një moment vërtet i jashtëzakonshëm në politikën botërore që mund të arrihej vetëm nga presidenti Trump", ka deklaruar Herzog.

Miratimin e planit nga OKB-ja e përshëndeti edhe ministri i Jashtëm gjerman, Johann Wadephul, që e quajti hap vendimtar për të dy popujt.

"Rezoluta është hap vendimtar për një të ardhme paqësore dhe për pajtim midis Izraelit e palestinezëve, dhe për këtë arsye është një moment i rëndësishëm për ne, në rrugën drejt një të ardhmeje të mirë, të cilën e mirëpresim se gjithë zemër", ka theksuar Wadephul.

Edhe në Autoritetin Palestinez shprehën gatishmëri për të marrë pjesë në zbatimin e planit. Por Hamasi shprehu kundërshtim për rezolutën, duke thënë se ajo nuk i përmbush të drejtat dhe kërkesat e palestinezëve.

"Rezoluta e vendos një mekanizëm të kujdestarisë ndërkombëtare mbi Rripin e Gazës, të cilin populli vetë dhe fraksionet tona e kundërshtojnë", ka shkruar grupi palestinez.

Mike Waltz, ambasadori amerikan në OKB, tha se rezoluta, e cila përfshin planin 20-pikësh të Trumpit si aneks, "hap një rrugë të mundshme drejt vetëvendosjes për palestinezët ... ku në vend të raketave do të ketë degë të ullirit dhe ku ekziston mundësia për t'u pajtuar për një horizont politik".

Rusia, e cila ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit, e kishte lënë të hapur më herët mundësinë e kundërshtimit, por u përmbajt nga votimi, duke lejuar që rezoluta të kalojë.

Ambasadorët e Rusisë dhe Kinës në OKB, u ankuan se rezoluta nuk i jep OKB-së rol të qartë në të ardhmen e Gazës.

E propozuesi i rezolutës, presidenti Trump, e cilësoi votimin si moment me përmasa historike teksa paralajmëroi se shumë njoftime të tjera emocionuese do të bëhen publike në javët në vijim.

Me këtë rezolutë forca ndërkombëtare e vendosur në Gazë do të punojë me Izraelin dhe me Egjiptin, krahas forcës së re policore palestineze, për t'i mbrojtur kufijtë dhe për ta siguruar procesin e çarmatosjes së grupeve të armatosura, përfshirë Hamasin.

VRASJA E GAZETARIT JAMAL KASHOGGI

Trumpi kundërshton Inteligjencën amerikane, thotë se princi saudit s'dinte për vrasjen e Kashoggit

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka hedhur poshtë të martën mundësinë që princi saudit i kurorës, Mohammed bin Salman, të ketë ditur për vrasjen e gazetarit saudit, Jamal Kashoggi, në vitin 2018. Pretendimi i Trumpit gjatë një takimi me Bin Salman të martën në Shtëpinë e Bardhë, del në kundërshtim me raportin e CIA-s se princi kishte miratuar vrasjen e kolumnistit të "Washington Post" në vitin 2018

WASHINGTON, 18 NËNTOR (CNN) – Presidenti amerikan, Donald Trump, ka hedhur poshtë të martën mundësinë që princi saudit i kurorës, Mohammed Bin Salman, të ishte në dijeni për vrasjen e Jamal Khashoggi në vitin 2018, duke pretenduar se gazetari disident saudit ishte "jashtëzakonisht i diskutueshëm".

Trumpi po ashtu ka thënë se ngritja e temës në takimin e tij me princin saudit, Mohammed bin Salman, kishte për qëllim të turpëronte vizitorin e tij.

"Po përmendni dikë që ishte jashtëzakonisht i diskutueshëm. Shumë njerëzve nuk u pëlqeu ai zotëri për të cilin po flisni. Pavarësisht nëse ju pëlqeu apo jo, ndodhin gjëra", ka thënë Trumpi në Zyrën Ovale gjatë takimit me Bin- Salman.

Trumpi për më tepër ka këmbëngulur se princi bin Salman, për të cilin CIA kishte vlerësuar atë kohë se kishte të ngjarë ta kishte urdhëruar vrasjen, nuk ishte i përfshirë.

"Ai nuk dinte asgjë për këtë, dhe mund ta lëmë me kaq. Nuk keni pse ta turpëroni mysafirin tonë duke bërë një pyetje të tillë", është shprehur Trumpi.

Kur u pyet në Zyrën Ovale për vrasjen e Khashoggit, princi i kurorës tha se "është e dhimbshme dhe është një gabim i madh". Ai po ashtu ka mbrojtur hetimin.

"Lidhur me gazetarin është vërtet e dhimbshme të dëgjosh se dikush ka humbur jetën pa ndonjë qëllim të vërtetë ose në mënyrë jo të ligjshme, dhe kjo ka qenë e dhimbshme për ne në Arabinë Saudite", është shprehur princi bin Salman.

Ai ka shtuar se Arabia Saudite "ka bërë të gjithë hapat e duhur të hetimit" duke thënë se "ne po bëjmë çmos që kjo të mos ndodhë përsëri".

E marta shënon vizitën e parë të princit në Washington që nga viti 2018, muaj para vrasjes së Khashoggit në një konsullatë saudite në Turqi.

Vlerësimi i CIA-s, i publikuar në vitin 2021, thoshte se princi kishte miratuar vrasjen e kolumnistit të "Washington Post", megjithëse ai prej kohësh ka mohuar çdo përfshirje.

"Ne e bazojmë këtë vlerësim në kontrollin e princit të kurorës mbi vendimmarrjen në Mbretëri, përfshirjen e drejtpërdrejtë të një këshilltari kyç dhe anëtarëve mbrojtës të Muhammad bin Salman në operacion, dhe mbështetjen e princit të kurorës për përdorimin e masave të dhunshme për të heshtur disidentët jashtë vendit, përfshirë Khashoggin", ka thënë raporti.



Ndërkohë gjatë takimit të së martës në Zyrën Ovale, Trumpi dhe Bin Salman kanë diskutuar edhe për çështje të tjera, përfshirë ekonominë.

Princi saudit është zotuar se Arabia Saudite do të investojë deri në 1 trilion dollarë në SHBA, një premtim që ishte bërë edhe gjatë muajit maj, gjatë takimit mes dy liderëve në kuadër të vizitës së Trumpit në shtetet e Gjirit.

SHKURT

Gazetari kroat paraqet Vuçiqin në prokurorinë italiane lidhur me "Sarajevo Safari"

ZAGREB, 18 NËNTOR - Gazetari hulumtues kroat, Domagoj Margetiq, ka bërë të ditur se ka informuar zyrën e prokurorit publik në Milano lidhur me njohuritë që ka për lidhjen e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, me "turizmin e snajperëve" në Sarajevë, gjatë kohës së luftës. "Ia kam bashkëngjitur raportit të gjitha provat, video-materialet, dokumentacionin fotografik, dokumentacionin audio dhe video, si dhe dokumentacionin nga media e asaj kohe, që kam", ka njoftuar Margetiq në rjetet sociale. Sipas tij, ato renditen të gjitha të dhënat konkrete që lidhin presidentin serb, Vuçiq me "turizmin e snajperëve" në Sarajevën e kohës së luftës, dhe të cilat, siç ka thënë, pa asnjë dyshim e vendosin atë në kohën dhe vendin e këtyre krimeve gjatë rrethimit të Sarajevës nga viti 1992 deri më 1996. Javën e kaluar është bërë e ditur se prokurorët e Milanos kanë hapur hetimin e tyre ndaj veprimeve të kohës së luftës në Sarajevë, të ashtuquajtura "Sarajevo Safari". Hapja e hetimeve ka nisur pasi gazetari dhe shkrimtari italian, Ezio Gavazzeni, ngriti një padi me akuzat se italianët dhe të huaj të tjerë kishin paguar anëtarë të ushtrisë të serbëve të Bosnjës për t'u transportuar në Sarajevë dhe për të qëlluar mbi civilët, një veprim që disa e quanin "turizëm snajperësh".

Dhoma e Përfaqësuesve voton pro publikimit të dosjeve "Epstein"

WASHINGTON DC, 18 NËNTOR (BBC) - Dhoma e Përfaqësuesve e SHBA-së ka votuar me shumicë dërrmuese për ta detyruar Departamentin e Drejtësisë t'i publikojë të gjitha dosjet për "Jeffrey Epstein". Projektligji dypartiak tani do të duhet të kalojë një votim në Senat përpara se presidenti Donald Trump ta nënshkruajë atë në ligj. Viktimat e Epsteinit kanë folur në një konferencë shtypi në Kapitolin e SHBA-së para votimit. Annie Farmer ka thënë se ato kanë vuajtur "tradhti institucionale" për vite me radhë. Duke folur përkrah viktimave, kongresmenia republikane Marjorie Taylor Greene sulmoi ish-aleatin e saj Trump. Taylor Greene, të cilën Trumpi e ka quajtur "tradhtare" ka thënë se çështja Epstein e ka "shqyer Maga-n", lëvizja e Trumpit "Make America Great Again". Ishte Donald Trumpi ai që ka bërë thirrje ditë më parë që partia e tij të votojë për publikimin e dosjeve. Trumpi ka thënë më parë se i kishte prerë lidhjet me Epsteinin shumë vite më parë. Ai gjithmonë ka mohuar çdo lidhje me abuzimin seksual dhe trafikimin e Epstein.

Zelensky flet për riaktivizim të procesit diplomatik për fundin e luftës në Ukrainë

MADRID, 18 NËNTOR (REUTERS) - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë të martën se Ukraina do të përpiqet të "riaktivizojë" procesin diplomatik për t'i dhënë fund luftës së vendit të tij me Rusinë. "Është e rëndësishme të kemi mbështetje për këtë", ka thënë Zelensky në një konferencë shtypi në Madrid së bashku me kryeministrin e Spanjës, Pedro Sanchez. Më vonë, ai ka thënë se planifikonte të diskutonte me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, të mërkurën, se si të arrijë një "paqe të drejtë" në Ukrainë. Turqia ishte vendi i bisedimeve midis përfaqësuesve ukrainas dhe rusë në pranverën e vitit 2022, si dhe në fillim të këtij viti, por ato nuk arritën të sillnin fundin e luftimeve.

SFIDA E STUDENTËVE TË VERBËR NË KORENË E JUGUT

Provimi 13-orësh, ndër më të gjatit në botë, sfida e nxënësve të verbër koreanojugorë

Çdo vit më shumë se 550. 000 nxënës në Kore të Jugut përballen me provimin e vështirë Suneung, i cili përcakton jo vetëm pranimin në universitet, por edhe mundësi të ardhshme në jetë. Për nxënësit e verbër, testi zgjat deri në 13 orë për shkak të versioneve në Braille dhe pajisjeve ndihmëse, duke e bërë sfidën jo vetëm akademike, por edhe fizike dhe mendore. Përveç lodhjes së gjatë, ata përballen me mungesë qasjeje të hershme në materiale studimore, duke bërë suksesin e tyre një dëshmi të vërtetë të qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes



SEUL, 18 NËNTOR (BBC) - Çdo nëntor Koreja e Jugut mban provimin e saj famëkeq të pranimit në universitet.

Dyqanet mbyllen, fluturimet shtyhen për të reduktuar zhurmën dhe madje edhe ritmi i udhëtimit të mëngjesit ngadalësohet për t'u liruar rrugë nxënësve.

Pasdite vonë, shumica e atyre që marrin pjesë në provim dalin nga portat e shkollës, duke marrë frymë me lehtësim dhe duke përqafuar familjarët që i presin jashtë.

Por jo të gjithë e mbarojnë në atë orë. Edhe pasi nata ka rënë plotësisht dhe terri ka mbuluar qytetin, disa nxënës ende ndodhen në sallën e provimit – duke e përfunduar atë afërsisht në orën 22:00.

Ata janë nxënësit e verbër, të cilët shpesh kalojnë më shumë se 12 orë duke bërë versionin më të gjatë të provimit Suneung.

Më 13 nëntor, më shumë se 550.000 nxënës në mbarë vendin u ulën për të dhënë Suneung, një shkurtesë për Testin e Aftësisë Shkollore për Universitet (CSAT) në gjuhën koreane. Ky është numri më i lartë i aplikantëve në shtatë vjetët e fundit.

Ky provim, nuk përcakton vetëm nëse dikush do të mund të shkojë në universitet, por mund të ndikojë edhe në mundësitë për punësim, të ardhurat, vendbanimin madje edhe në marrëdhëniet e ardhshme.

Provim pa asnjë pushim

Në varësi të lëndëve që zgjedhin, nxënësit përgjigjen në rreth 200 pyetje që përfshijnë gjuhën koreane, matematikën, anglishten, shkencat shoqërore ose natyrore, një gjuhë të huaj shtesë dhe Hanja (shkrim në karaktere kineze klasike të përdorura në koreane).

Për shumicën e nxënësve kjo është një maratonë tetorëshe provimesh pa pushim. Ata e fillojnë testin në orën 08:40 dhe e përfundojnë rreth 17:40.

Nxënësit e verbër me dëmtime të rënda të shikimit, megjithatë, kanë të drejtë për 1.7 herë më shumë kohë sesa koha standarde e testimit.

Kjo do të thotë se nëse ata zgjedhin edhe seksionin e gjuhës së huaj shtesë, provimi mund të përfundojë edhe deri në 21:48 - gati 13 orë pasi ka filluar.

Nuk ka pushim për darkë; provimi vazhdon pa ndërprerje.

Edhe vëllimi fizik i fletëve të provimit në alfabetin Braille ndikon në zgjatjen e kohës.

Kur çdo fjali, simbol apo diagram konvertohet në Braille, secili libër testimi bëhet gjashtë deri në nëntë herë më i trashë se versioni standard.

Në Shkollën Hanbit për të Verbrit në Seul, 18-vjeçari Han Donghyun është ndër nxënësit që i është nënshtruar versionit më të gjatë të Suneung-ut këtë vit.

Vitin e kaluar në të gjithë vendin kishte 111 nxënës të verbër që morën pjesë në provim - 99 me shikim të dobët dhe 12 me dëmtime të rënda të shikimit, si Dong-hyun - sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Instituti Korean për Kurrikulën dhe Vlerësimin.

Dong-hyun ka lindur plotësisht i verbër dhe nuk mund të dallojë as dritën.

Kur BBC e takoi në shkollën e tij më 7 nëntor, gjshtat e tij lëviznin me shpejtësi mbi një libër praktikimi në alfabetin Braille, me pyetje nga provimet e kaluara.

Me vetëm një javë të mbetur para testit, ai ishte përqendruar në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe gjendjes së tij fizike. Dong-hyun do ta japë provimin duke përdorur fletët e provimit në Braille dhe një kompjuter me program leximi zanor.

"Është vërtet rraskapitëse sepse provimi është shumë i gjatë", tha ai. "Por nuk ka ndonjë trik të veçantë. Thjesht ndjek orarin tim të studimit dhe përpiqem të ruaj gjendjen time. Kjo është e vetmja mënyrë".

Dong-hyun tha se pjesa e gjuhës koreane është veçanërisht e vështirë për të.

Një libër standard testi për këtë seksion ka rreth 16 faqe, ndërsa versioni në Braille ka rreth 100 faqe.

Edhe me softuerin që lexon tekstin me zë, informacioni i dëgjuar zhduket menjëherë pasi dëgjohet, ndryshe nga teksti që mund të shihet dhe rilexohet. Dong-hyun duhet t'i mbajë të gjitha detajet në kujtesë ndërsa punon me to.

As pjesa e matematikës nuk është më e lehtë.

Ai duhet të interpretojë grafika dhe tabela komplekse të konvertuara në Braille, vetëm përmes majave të gishtave.

Megjithatë, ai vuri në dukje se gjërat janë përmirësuar krahasuar me të kaluarën. Dikur, nxënësit duhej të bënin pothuajse të gjitha llogaritjet në mendje. Por që nga viti 2016, studentëve të verbër u lejohet të përdorin një pajisje për shënime në Braille, të njohur si Hansone.

"Ashtu si nxënësit me shikim që i shkruajnë llogaritjet me laps, ne i shkruajmë në Braille në pajisjen Hansone për të ndjekur hapat", tha ai.

Një tjetër nxënës në Shkollën Hanbit për të Verbërit, Oh Jeong-won, 18 vjeç, i cili gjithashtu i është nënshtruar provimin Suneung këtë vit, tha se pasditja e vonë është "pika më e vështirë" e ditës.

"Deri në drekë, është e përballueshme", tha ai. "Por rreth orës 4 ose 5 pasdite, pas anglishtes dhe para Historisë Koreane bëhet vërtet e lodhshme.

"Nuk ka pushim për darkë", shpjegoi ai. "Ne zgjidhim probleme në orarin kur normalisht do të hanim, ndaj edhe është më rraskapitëse. Megjithatë, vazhdoj, sepse e di që në fund do të ndiej një ndjenjë arritjeje".

Për Jeong-won lodhja shtohet edhe më shumë nga nevoja për të qëndruar i përqendruar me të dyja duart dhe dëgjimin.

"Kur lexoj tekstin në Braille me gishtat e mi dhe njëkohësisht marr informacion përmes audios, ndihem shumë më i lodhur sesa nxënësit me shikim", tha ai.

Mungesa e qasjes në materiale

Por studentët thonë se kohëzgjatja e provimit dhe orët e gjata të studimit nuk janë pjesët më të vështira. Sfida më e madhe është qasja në materialet e studimit.

Tekstet e njohura shkollore dhe leksionet online, mbi të cilat mbështeten nxënësit me shikim, shpesh janë të paarritshme.

Edhe leksionet online paraqesin vështirësi, pasi shumë mësues shpjegojnë konceptet duke përdorur shënime vizuale, diagrame dhe grafika në ekran, të cilat nuk mund të ndiqen vetëm përmes audios.

Megjithatë, një nga pengesat më të mëdha është vonesa në marrjen e versioneve në Braille të librave përgatitorë shtetërorë të EBS-it - një grup materialesh thelbësore, që lidhen ngushtë me provimin kombëtar.

Për shkak të kësaj vonese, nxënësit e verbër shpesh i marrin këto materiale me muaj vonesë në krahasim me nxënësit e tjerë.

"Nxënësit me shikim të plotë marrin librat e tyre të EBS-it midis janarit dhe marsit dhe i studiojnë gjatë gjithë vitit," tha Jeong-won. "Ne i marrim skedarët në Braille vetëm rreth gushtit ose shtatorit, kur provimi është vetëm disa muaj larg".

Dong-hyun ndan të njëjtin shqetësim.

"Materialet në Braille nuk u përfunduan deri më pak se 90 ditë para provimit," tha ai. "Gjithmonë kam dëshiruar që procesi i botimit të ishte më i shpejtë."

Instituti Kombëtar i Arsimit Special, që prodhon versionet në Braille të materialeve të provimit të EBS-it, i tha BBC-së se procesi zgjat të paktën tre muaj për çdo libër, sepse duhet të ndjekë udhëzimet përkatëse.

Instituti shtoi se po "bën përpjekje të ndryshme për të siguruar që nxënësit e verbër të mund të studiojnë pa pengesa, si p.sh. prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve në volume të veçanta".

Unioni Korean i të Verbërve tha se e ka ngritur këtë çështje prej kohësh me autoritetet dhe planifikon të paraqesë një peticion kushtetues, duke kërkuar qasje më të madhe në versionet në Braille të të gjitha teksteve shkollore. Për këta nxënës, Suneung nuk është thjesht një provim pranimi në universitet - është dëshmi e viteve të sakrificës dhe qëndrueshmërisë që i kanë sjellë deri këtu.

Jeong-won e përshkroi provimin si një provë të durimit dhe këmbënguljes.

"Në jetë pothuajse asgjë nuk mund të bësh pa qëndrueshmëri", tha ai. "Mendoj se kjo periudhë është një proces për të sërvitur vullnetin tim".


Mësuesi i tyre, Kang Seok-ju, i sheh nxënësit të kalojnë nëpër provim çdo vit dhe thotë se forca e nxënësve të verbër është e jashtëzakonshme.

"Të lexosh në Braille do të thotë të ndjekësh pika të ngritura me majat e gishtave. Fërkimi i vazhduesh mund t'i bëjë duart e tyre të dhembin shumë", theksoi ai. "Por ata vazhdojnë për orë të tëra".

Kang u bëri thirrje nxënësve të tij të vlerësojnë përfundimin e provimit, në vend që të pendohen.

"Ky provim është ai moment kur shfaq gjithçka që ke mësuar që nga klasa e parë në një ditë të vetme", tha ai. "Shumë nxënës ndihen të zhgënjyer pas tij, por unë dua që ata të largohen duke e ditur se kanë bërë më të mirën e tyre. Provimi nuk është gjithçka".

Përktheu: Blerta Haxhiu



Autor: Jeton Mikullovci

SHËNIME MARGJINALE

Edhe një rrëfim i përbashkët i dy shteteve

Për një çerekshekull në Serbi qe normalizuar shpjegimi se në BE mund të hyhet me Rusinë e në Shqipëri se kjo mund të bëhet me paratë e drogës. Sanksionet amerikane tërheqin vërejtjen se ky shpjegim nuk është normal më



Veton Surroi

1.

Shqipëria dhe Serbia mund të gjenden sërish në një rrëfim të përbashkët. Para disa vjetësh ishin bërë pjesë prijëse e rrëfimit të "Ballkanit të Hapur", një iniciativë që mori shumë energji dhe prodhoi tepër pak rezultate, e tani këto dy shtete gjenden në një kontekst në të cilin dy vendime amerikane mund të përcaktojnë bukur shumë ardhmërinë e afërt të tyre. Dhe, për ta bërë gjendjen edhe më të ndërlikuar, këto nuk janë vendime kundër Shqipërisë dhe Serbisë - që të dyja shtetet kanë marrëdhënie të mira me SHBA-në, madje në që të dyja pritet të bëhen investime të rëndësishme - një resort në Sazan, një hotel luksoz në ish-Shtatmadhorinë ushtarake në Beograd- të njërit prej investitorëve me peshë specifike, Jared Kushner, i cili gëzon besimin e presidentit Trump në operacione të ndërlikuara çfarë ishte negociimi i armëpushimit në Gazë.

Vendimet janë të natyrës "sekondare", dytësore dhe janë shumë të ndryshme prej njëri-tjetrit.

Njëri vendim është ai i sanksionimit të Departamentit të Thesarit kundër pjesëtarëve të familjes Hysa nga Belshi i Elbasanit, me shtetësi meksikane, e të cilët cilësohen si shpëlarës të parave të njërit prej klaneve më të njohura të drogës në Meksikë e gjetiu, të Klanit Sinaloa.

Tjetri vendim është ai i sanksioneve amerikane kundër naftës ruse, ndaj të gjithë atyre që e blejnë a shesin këtë e ndaj të cilëve mund të shtrihen ndëshkimet ekonomike e ligjore amerikane.

2.

Nëse në Shqipëri ekziston ndonjë dyshim se ku çojnë këto sanksione, do të ishte mirë që të mësohet prej Serbisë.

SHBA-ja ka paralajmëruar prej kohësh Serbinë - që nga administrata e parë Trump - se ajo duhet të diversifikojë resurset energjetike, se nuk duhet të mbështetet tek Rusia e të krijojë varësi prej saj. Kjo varësi është saktësisht çka i ndodhi Serbisë dhe në ndërlidhje të energjisë e gjeopolitikës Serbia e futi veten në një kurth të trefishtë: ia shiti kompaninë e vet të naftës NIS Rusisë , u drejtua kah importi i gazit dhe naftës nga Rusia si burim parësor energjetik dhe tërë këtë varësi e mbështolli me shfrytëzimin e vetos ruse ndaj Planit Ahtisaari në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Që nga fillimi i luftës në Ukrainë , presidenti Vuçiq ka shpërfillur sanksionet e BE-së ndaj Rusisë dhe ka vazhduar të importojë gaz e naftë prej Rusisë duke mbajtur në të njëjtën kohë me sukses NIS (Industrinë e Naftës të Serbisë) në pronësi mazhoritare ruse. Kjo gjendje do të vazhdonte pa problem po të mos ishte ndërhyrja e sanksioneve amerikane që dënon të gjithë ata që bëjnë tregti me energjinë ruse. Këto sanksione, të drejtuara fillimisht kundër Kinës e Indisë –vende të cilat shfrytëzuan embargon ndaj Rusisë për ta blerë (e mbase shitur) energjinë e lirë ruse, arritën edhe në adresën e Serbisë, e cila duhet të largojë qartazi pronësinë ruse në industrinë e vet energjetike.

3.

Shqipëria nuk është e sanksionuar me familjen Hysa, siç nuk ishte e sanksionuar Serbia me ndëshkimin "sekondar". Por, për dallim prej Serbisë, së cilës me vite të tëra i është tërhequr vërejtja për monopolin energjetik rus, Shqipërisë nuk i është tërhequr vërejtja për këtë apo ndonjë familje tjetër, qoftë me rezidencë në Meksikë, Ekuador a gjetiu, për monopol në ndonjë aktivitet legal apo jolegal. Dhe, për më tepër, aktivitetet e sanksionuara të kësaj familjeje janë kryesisht në kontinentin amerikan - madje, asnjë në Shqipëri.

E, megjithatë, Shqipëria do të duhej të ishte e brengosur nga sanksionimi i kësaj familjeje nga administrata amerikane. Fillimisht, ngase figura e saj kryesore kishte paralajmëruar publikisht hyrjen në Shqipëri nëpërmjet kazinove (tash të sanksionuara në Kanada, Meksikë e gjetiu) dhe këtë e bëri pas takimit me kryeministrin e vendit. Dhe së dyti, ngase në Shqipëri tashmë është vendosur kultura e amnistimit të prejardhjes së parasë që hyn në vend, me çfarëdo kanali që të hyjë.

Paraja informale që ka hyrë dhe po qarkullon në Shqipëri ka pasur efekt dramatik transformativ. Ka rritur valë të paprecedent ndërtimi në gjerësi e lartësi të vendit, ka rritur shumëfishimin e investimit në turizëm, ka krijuar çekuilibrim në fusha të tjera të ekonomisë së çmimeve e kursit të lekut dhe ka pasur ndikimin e vet në krijimin e një klime politike që, duke qenë gjithnjë e më larg demokracisë e transparencës, është më e favorshme për të mos shtruar pyetje për prejardhje parash, sundim të ligjit dhe rregullave demokratike.

Kam përshtypjen se pushteti në Shqipëri është në një situatë analoge ku ishte pushteti i Serbisë - i thuhej se do të ishte mirë që të mos varej prej Rusisë. Analogjia mbase nuk është aq e hapur - Shqipërisë po i thuhet mbase që të mos krijojë varësi prej parasë së kontrabandës së drogës, potencialisht.

4.

Dallimet mes Shqipërisë e Serbisë janë shumë të mëdha. Shqipëria nuk ka qenë ndonjëherë më afër anëtarësimit në BE dhe anëtarësimi - në një kombinim shtytjesh gjeopolitike dhe nevoje të shteteve kandidate - nuk ka qenë ndonjëherë më i prekshëm për shtetet kandidate si Shqipëria e Mali i Zi. Serbia, nga ana tjetër, ka bërë çdo veprim të mundshëm që ta kthente kahun e integrimit prapa, madje duke u kthyer në një gjendje në të cilën vështirë që do të mund të kalonte sot në një proces që çon deri te Marrëveshja e stabilizim-asociimit.

Në të folurit e BE-së, Serbia ka mundur për një çerekshekulli të betohet në rrugën evropiane duke e mbajtur për krahu apo duke u mbajtur për krahu me Rusinë. Shqipëria ka mundur të betohej në rrugëtimin evropian duke u shndërruar njëkohësisht në njërën prej pikave kryesore në hartën botërore të karteleve të trafikut të drogës, gjegjësisht të kaheve financiare të saj.

Këto nuanca evropiane janë të huaja për administratën sanksionuese amerikane. Porosia për pushtetet në Serbi dhe Shqipëri – për Serbinë imediate, Shqipërinë pasuese - është se duhet të vendosin se nuk ka më rrugëtim në të cilin BE-ja dhe Rusia janë në të njëjtin ndjehtim; apo BE-ja dhe paketat e drogës e paratë nga ajo.

Për një çerekshekull në Serbi qe normalizuar shpjegimi se në BE mund të hyhet me Rusinë për krahu e në Shqipëri me paratë e drogës në dorë. Sanksionet amerikane tërheqin vërejtjen se ky shpjegim nuk është normal më.

OPINION

Urrejtja ndaj Alter Egos

Ben Andoni

Ka bërë përshtypje vetëm pak minuta përgjigjja e kryeministrit Rama në një intervistë gjatë takimit të qeverive italo-shqiptare, sipas së cilës nuk e ka një bir politik që ta zëvendësojë. Nëse do të përbënte habi atëherë, ajo do të komentohej, analizohej dhe do të shikoheshin madje edhe përfytyrimet e liderëve të Shqipërisë së ardhshme. Askush nuk e merr me mend sot identikitin e zëvendësit të Ramës dhe njeriut që do ta drejtojë pas tij Partinë Socialiste. Është aq e madhe diferenca e kultit që i kanë ngritur, saqë përmendja e emrave alternativë përjetohet thjesht si grotesk. Në kampin tjetër, nëse do të përmendësh ndonjë pasues të Berishës pas rastit "Basha" do të jetë herezi. Kush të dojë le të vijë dhe të përballet në votime, shprehet Berisha, figura më e madhe politike e këtyre 35 vjetëve me ulje-ngritje të paimagjinueshme. Përçmimi ndaj Alter Egos së tyre poli tike është e hapur dhe cinike. Askush nuk mund të barabitet me ta. Propaganda rreth Ramës e ndihmon, kurse kërkesat e zbehta ndaj Berishës për reflektim mbeten në eter.

E para, sepse demokracia e brendshme te PD-ja është e shkëlqyer në formë, por krejt e gënjeshtërt në realitet. Rasti i promovimit të Bashës, primareve, listat inferiore të kandidatëve janë disa nga shfaqjet më të hapura të këtij argumenti. Kurse tek PS-ja s'ka nevojë për propagandë, sepse Rama diktON me fuqinë e Ekzekutivit që drejton. Nuk jep llogari para pushtetit legjislativ; Presidenca nuk i shkakton asnjë kokë dhimbje me firmat mbi dekrete; partia është kthyer në një detashment (koreografia e heshtjes në Asamble dhe kurdo e tregon këtë); performanca ndërkombëtare me hapjen dhe të clusterit të fundit është lëbyrëse prej kryeministrit shqiptar. Propaganda e tij tashmë është e thjeshtë, sepse është direkte: "Me Edin në Evropë në vitet '30". Te Berisha, propaganda është edhe më e saktë: "Askush nuk e hedh Ramën, veç Berishës". Edhe më i qarti tek PD-ja, pasi del pak nga rreshti, kthehet tek e njëjta pikë: Po, vetëm me Berishën! 'Ciniku' shekullor Noam Chomsky me fushëpamjen e tij e ka një ide për këtë ngërç demokratik: "Ky është i gjithë qëllimi i propagandës së mirë. Duhet të krijosh një slogan kundër të cilit askush nuk do të jetë dhe të gjithë do të jenë pro. Askush nuk e di se çfarë do të thotë, sepse nuk do të thotë asgjë".

Ka një logjikë e cila shkon më shumë në aspektin antropologjik. Në Evropën Lindore, është e natyrshme dhe krejt e zakonshme që elitat politike t'i shmangin qoftë edhe në retorikë pasardhësit. Rasti i Serbisë, Hungarisë, Federatës së Bosnjës (sidomos Republikës Sërpska), Polonisë, Bullgarisë, Gjeorgjisë, janë shembuj të mirë ilustrativë. Një përgjigje për ne shqiptarët është e kuptueshme: Kultura politike post komuniste është e lidhur me kujtimin e frikës së brendshme, ku kundërshtarët eliminoheshin sepse të rrezikonin postin. Rasti shqiptar është ilustrim i saktë i masakrës që bëri Enver Hoxha me njerëzit më të afërt me të cilët fitoi dhe mbajti pushtetin pas Luftës së Dytë Botërore. Tek PS-ja sot njerëzit me të cilin Rama nisi qeverisjen nuk duken më as nëpër foto, sepse janë shmangur ose më keq janë në burgje dhe të penalizuar. Më keq tek PD-ja. Ata që provuan të ngrinin qoftë edhe zërin ndaj Berishës nuk ekzistojnë më. Njësoj, partitë kudo në Lindje nuk i ngrënë demokracitë e brendshme mbi institucione por mbi individë. Statutet e partive edhe pse janë të qepura mirë sipas kanoneve demokratike nuk funksionojnë. Vetëm të mendosh se në instancë të fundit japin llogari te kryetari i Partisë e kupton sesa efikase të jenë ato. Po të funksiononte statuti i Partisë Demokratike nuk do ndodhte kurrë ndarja me Bashën dhe çoroditjet e Berishës me "Foltoren". Nëse nuk ishe besnik ndaj Berishës do ta shikoje veten tek Lista e Hapur (ashtu si ndodhi), ku probabiliteti i zgjedhjeve në votimet e këtij viti ishte minimal. E sa për ideologjinë, ajo është harruar prej kohësh. Partia Socialiste sillet normale si e Djathtë dhe lidhjet më të mira i ka me qeveritë e Djathta problematike (mes tyre Meloni, Orban), ashtu si Partia Demokratike flet normal me diskurs të Majtë, e para sepse do të thithë elektorat të kësaj fashe që është shumë i madh në vend dhe e dyta, sepse do të tregojë fytyrë shumë sociale në masën e madhe të publikut.

Ndërkohë në vendin tonë, sfida më e madhe demokratike është dhe do të mbeten zgjedhjet. Ende tek ne votohet nga influencat krahinore dhe sidomos me përdorimin e masës së madhe të administratës e pushtetit, defekte të parapara dhe të reklamuara shpesh nga OSBE-ODHIR. Partitë shfaqin dobësi në terren sepse e harrojnë krejt bazën dhe mbi të gjitha zhurma e partive të vogla e "çorodit" skakierën politike. Në këto kushte, Rama dhe Berisha shfaqin dukjen e tyre dhe i identifikojnë zgjedhjet me emrin e tyre. Sistemi i qepur nga reforma e përbashkët zgjedhore PS dhe PD e mbështet forcën e tyre, madje edhe në listat e hapura, është shfaqja e tyre direkte apo indirekte që ndikon. Sa i përket alter egos së kryetarëve harroje, ata as nuk ekzistojnë edhe në ëndrra. Rama ka kohë që thotë se do të largohet kur të dojë vetë dhe, me një diskurs po të ngjashëm, Berisha mëton se nuk do të largohet dhe se ka fuqinë e mjaftueshme të kthehet edhe në të tetëdhjetat e tij në pushtet. "Ka forcën e një të riu", thoshte z. Noka, një nga sekretarët e tij, duke aluduar për potencën seksuale! Në çdo lloj butaforie tregohet shtati i Ramës, si sfidë, dominim dhe siguri; ashtu si Berisha i kuruar që jep idenë e qëndrueshmërisë, duke shpjeguar me forcë katrahurën e qeverisë.

Në sisteme si tonat, fuqia e liderit ka ndikim oligarkik, ku gjallojnë rrjete biznespolitikë dhe klientelizëm dhe ku kuptohet se udhëheqësit veprojnë si pika fokale që shpërndajnë burimet. Sot, në media ka vazhdimisht referime sesi shumë nga lejet e ndërtimeve lidhen me njerëzit e Berishës, apo sesi njerëz të z. Rama kanë pushtet falë njohjes dhe koniunkturave me të. Zëvendësi i Ramës në arrati, Ahmetaj, ka rreshtuar disa syresh. Ndërkohë, mendo sikur një pasardhës të bjerë në këto burime, atëherë liderit suprem i bie pushteti dhe mundësitë, ndaj duket se udhëheqësit tanë e vonojnë trashëgiminë e tyre politike. Duket sikur postin duan ta marrin me vete…

Të shkon ndërmend momenti kur kancelari gjerman erdhi në Shqipëri dhe në pritjen protokollare revistuese para Muzeut Kombëtar, i bëri me shenjë Ramës (Fill pas zgjedhjeve): Ti, katër herë! Është e vërtetë që kancelarja Merkel qëndroi shumë, por institucionet gjermane funksionojnë. Ato britanike shumë më tepër. Madje edhe ato të fqinjëve italianë.

Gjithsesi në Shqipëri është i gjallë tranzicioni i tmerrshëm i kapërcyellit të viteve '90, viti i tmerrshëm '97 dhe katrahurat e mëtejshme. Kështu, liderë në ligjërimin publik mbetet garantuesi i stabilitetit, mbrojtësi i unitetit dhe njeriu që parandalon kaosin. Në rastin tonë, autor i kaosit ishte Berisha, që paradoksalisht sot është në fuqi, por tashmë si lider i opozitës.

Me pak fjalë, jo vetëm tek ne, por kudo në Lindje përgatitja e pasardhësve është e sikletshme, sepse mund të kushtojë politikisht për liderët, statutet nuk e mbështesin faktikisht dhe dekurajohen shpesh e vazhdimisht. Pushteti i liderëve varet nga autoriteti personal dhe këtë e kupton nëse ke problem me Ramën dhe Berishën, kur rrokullisesh në fund të karrierës.

(Panorama)

OPINION

Kush e nxit vetëgjyqësinë në Shqipëri?

Artur Ajazi

E çfarë flasësh më parë. Çfarë thuash më parë, për situatën ku ndodhet sot drejtësia. Një prokuror që "nuk gjen provat e duhura", një tjetër prokuror që "shkel afatet e paraburgimit", një gjyqtar që jep vendimin e pabazuar në ligj, një tjetër që nxjerr "të pafajshëm" vrasësin, vrasësit, grabitësit dhe të korruptuarit. Ku po vemi, ku po shkon ky vend dhe kjo shoqëri ? Reforma në drejtësi, flaku disa dhe mbajti disa, por siç duket duhej t'i kishte flakur 100 për qind nga radhët e drejtësisë. Vendimet e gjyqësorit dhe deformimet dhe devijimet e organit të akuzës, po nxjerrin vrasës nga qelia, po amnistojnë kriminelë me ngjarje të rënda të përsëritura, ndërkohë që janë pikërisht ata që po nxisin vetëgjyqësinë.

Policia e Shtetit, arreston kriminelin, dërgon provat në Prokurori, dhe pas 2-3 muajsh vrasësi del me vendim gjykate, ose në "arrest shtëpie" ose me "detyrim paraqitje". Dikush tjetër që grabit pronën e pronarit të ligjshëm (duke u justifikuar nga ligji famëkeq 7501), del nga arresti me vendim gjykate, dhe pas pak ditësh kërcet kallashi, dhe regjistrohen viktima. Natyrisht, kur vret, kur grabit, kur kryen krime dhe del nga qelia, mos prit gjëra të këndshme, mos prit rend dhe qetësi, pasi fajtori dihet. Është drejtësia e vonuar, drejtësia e "reformuar", drejtësia e korruptuar. Një skandal më i fundit i kësaj drejtësie pocaqi, mbetet lirimi nga qelia i atyre që dyshohen për vrasjen e E. P në Pogradec. Duke mos u marrë fare me emrat e tyre, Prokuroria ka "shkelur afatet e paraburgimit", pra nuk ka kryer hetimet në afatin ë duhur, kur fakte kishte sa të duash. Po ashtu edhe gjykata, i ka rënë shkurt, dhe i ka nxjerrë dy të akuzuarit për vrasje nga qelia. Sipas burimeve brenda gjykatës së Korçës, "për ata shtetas kishte përfunduar afati i paraburgimit dhe gjykata ka caktuar ndryshimin e masës në "arrest shtëpie" deri në përfundimin e hetimeve". Aktualisht çështja ka stopuar, deri në zbardhjen e kamerave të sigurisë të sekuestruara në lokalin ku ka ndodhur ngjarja, ndërsa pamjet filmike të fshira janë çuar jashtë Shqipërisë për ekspertim dhe për rikthim të tyre.

Por duket se vonesa në dokumentimin e plotë të ngjarjes, është bërë shkak që pala mbrojtëse e dy personave të akuzuar për vrasje, të kërkoj ndryshimin e masës së sigurisë për ta. Aktualisht pritet që ata të ndjekin vijimësinë e hetimeve jashtë qelisë, ndërsa ata akuzohen për "vrasje me dashje, e kryer në bashkëpunim". Atëherë, çfarë duhet të presin shqiptarët nga drejtësia e reformuar ? Drejtësia ka probleme të mëdha me veten, pasi ende Vettingu, nuk ka nxjerrë nga radhët e saj, vemjet e korruptuara. Reforma në drejtësi, pa asnjë mëdyshje mund të quhet sot e dështuar. Kjo, për faktin sepse korrupsioni mbetet akoma "gangrenë" që po gërryen strukturat e saj, dhe dëmton shqiptarët.

Vendimet e dyshimta nga gjykatat, por edhe hetimet e zvarritura nga organi akuzës, po nxisin vetëgjyqësinë në Shqipëri. Mjafton ti hyjmë statistikave, dhe të shohim dhe numërojmë sa janë vrarë nga vendimet e paligjshme të gjykatave, dhe akuzat e zbutura nga organi akuzës, për të vënë ulërimën. Si mund të pretendojmë ne se, do të hyjmë në BE, kur kemi akoma një drejtësi të molepsur, një prokurori dhe gjykatë që nxjerr të "pafajshëm" kriminelët, grabitësit e pronave të ligjshme, të korruptuarit, dhe bashkëpunëtorët e tyre. Por defekti më i madh në Shqipëri, qëndron në faktin, sepse tek ne ka marrë fund ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi qytetar, forca e arsyes dhe mendimit juridik, për zgjidhjen e problemeve sipas ligjit.

Është koha t'i themi "NDAL" paaftësisë dhe korrupsionit në organet e drejtësisë, si i vetmi shkak madhor në nxitjen e urrejtjes mes shqiptarëve, dhe vetëgjyqësisë mes tyre. Ashtu siç është momenti që të ndalen dhe të merren serizoisht me fenomene dhe skandale të tilla, strukturat e larta që monitorojnë…. drejtësinë e re.

(Javanews)

Vështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë faqe nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:
Flaka SURROI

Redaksia

Kryeredaktore:
Brikenda REXHEPI

Zëvendëskryeredaktor:
Elmaz ISUFI

Ndihmëskryeredaktor/
Redaktor i kulturës:
Granit KURTI

Redaktorë përgjegjës:
Driton MEHMETI
Visar LOCI
Nita LLESHI-DOBROSHI
Besnik KRASNIQI

Redaktorë në Portal:
Endrit BERISHA
Shkumbin SEKIRAQA
Nora SHABANI-HYSENI
Besjana BAJRAMI-POLISI

Redaktorë/Autorë:
Mimoza KOPRIANI-MUÇAJ
Eraldin FAZLIU
Donika VOCA-GASHI

Ndihmësredaktore:
Minushe REXHEPI

Redaktor i sportit:
Arsim MAXHERA

Redaktor i mediave sociale/i qendrës grafike
Ben KAJTAZI

Fotografia:
Driton PAÇARADA

Adresa:
KOHA
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë)
Xhorxh Bush p.n.
10000 Prishtinë

Fahu postar 202

Telefonat:
(00 383 38) 249-104 249-105;
249-106; 248 014 dhe 248 015

e-mail:
redaksia@kohaditore.com;
lajmet@kohavision.net; info@koha.net

Marketing dhe shitje KOHA
(KOHA Ditore; KTV, Koha.net, ARTA dhe KOHA Print):
tel: (00 383 38) 249-104; 249-105; 249-106; 248 014 dhe 248 015
e-mail: marketing@koha.net
berat@koha.net, afrim@koha.net
marketing@kohaditore.com

Xhirollogaria:
ProCredit - 1110086926000189
NLB - 1701001010645930
TEB - 2011000000081423
Raiffeisen - 1501001002095874
BKT - 19012176320312 47
B. Ekonomike - 1401000000903831
BpB - 13002712000030870

Shtypshkronja "KOHA Print"
045 701 288

Marketingu për jashtë:
Era Press GmbH
Silhstrasse 38 CH-8001 Zürich
Tel.+41(0) 43 497 32 80
koha@erapress.ch

Nuk lejohet ribotimi i pjesshëm apo i plotë, në cilindo medium, i cilido material për të cilin KOHA (KOHA Ditore, KTV, KOHA.net, ARTA) i mban të drejtat e rezervuara, pa autorizimin paraprak me shkrim nga KOHA.

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës Ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOVODOVANJE D.O.O.
PRISHTINA

PUBLIC HEARING NOTICE

Environmental and Social Impact Assessment (ESIA) for the project "Climate Appropriate Urban Development: Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II)", Sewerage in Prishtina and Fushe Kosovo.

As part of an agreement between the Republic of Kosovo and the Federal Republic of Germany, this project will contribute to environmentally friendly, hygienically safe, and sustainable wastewater and stormwater management in Prishtina and Fushe Kosovo.

The public is hereby informed that a Public Hearing will be held for the presentation of the International Environmental and Social Impact Assessment (ESIA) for the above-mentioned project. The hearing will take place on:

- **Date:** 21/11/2025
- **Time:** 10:00
- **Venue:** Headquarters of the Regional Water Company Prishtina, Str. Hazir Shala no.4, 10000 Prishtina, Kosovo (*The venue is fully accessible, including for individuals using wheelchairs or requiring mobility assistance)*

The purpose of this Public Hearing is to present the ESIA findings, explain potential environmental and social impacts, and gather feedback from interested and affected stakeholders.

This hearing is open to the public. All stakeholders and interested parties are encouraged to attend and actively participate in the discussion.

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

NJOFTIM PËR DËGJIM/DEBAT PUBLIK

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore dhe Shoqërore (VNMS) për projektin "Climate Appropriate Urban Development: Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II), Kanalzimi ne Prishtinë dhe Fushë Kosovë

Në kuadër të Marrëveshjes mes Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ky projekt do të kontribuojë në menaxhim të qëndrueshëm të ujërave të ndotura dhe ujërave të shiut, në formë miqësore ndaj mjedisit dhe higjienikisht të sigurt në Prishtinë dhe Fushë Kosovë.

Publiku njoftohet se do të mbahet një Debat Publik për prezantimin e Vlerësimit Ndërkombëtar të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) për projektin e lartpërmendur. Debati do të mbahet në:

- **Data:** 21/11/2025
- **Koha:** 10:00
- **Vendi:** Zyrat Qendrore të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina, Rr. Hazir Shala nr. 4, 10000 Prishtina, Kosovë *(Vendi është plotësisht i qasshëm, përfshirë për përdorues të karrocave me rrota ose persona që kanë nevojë për ndihmë në lëvizshmëri.)*

Qëllimi i këtij Debati Publik është prezantimi i gjetjeve të VNMS, shpjegimi i ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale, si dhe mbledhja e komenteve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara dhe të prekura.

Ky debat është i hapur për publikun. Të gjitha palët e interesuara inkurajohen të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në diskutim.

OBAVEŠTENJE O JAVNOJ RASPRAVI

Procene uticaja na životnu sredinu i društvo (PUŽSD) za projekat "Climate Appropriate Urban Development: Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II)", Kanalizacija u Prištini i Fushë Kosovu

U okviru sporazuma između Republike Kosovo i Savezne Republike Nemačke, ovaj projekat će doprineti održivom upravljanju zagađenom vodom i kišnicom, na ekološki i higijenski bezbedan način u Prištini i Fushë Kosovu.

Obaveštava se javnost da će se održati Javna Rasprava radi predstavljanja Međunarodne Procene Uticaja na Životnu Sredinu i Društvo (ESIA) za navedeni projekat. Rasprava će se održati:

- **Datum**: 21/11/2025
- **Vreme**: 10:00
- **Mesto**: Centrala Regionalne Vodovodne Kompanije Prishtina, Ul. Hazir Shala br. 4, 10000 Priština, Kosovo *(Prostor je u potpunosti pristupačan, uključujući za korisnike invalidskih kolica i osobe kojima je potrebna pomoć pri kretanju.)*

Cilj ove Javne Rasprave je predstavljanje nalaza ESIA-e, objašnjenje mogućih uticaja na životnu sredinu i društvo, kao i prikupljanje povratnih informacija od zainteresovanih i pogođenih strana.

Rasprava je otvorena za javnost. Sve zainteresovane strane se ohrabruju da prisustvuju i aktivno učestvuju u diskusiji.

NJOFTIM
PËR TË GJITHA PALËT E INTERESIT

Dëgjim Publik mbi "Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujit 2026-2028" i organizuar nga ARRU dhe KRU "Prishtina"sh.a.
Në ambientet e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh.a., rr. Hazir Shala nr.4, më 03.12.2025 duke filluar nga ora 9:30, do të mbahet dëgjimi publik lidhur me Procesin Tarifor 2026–2028 për zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" sh.a.
Ky dëgjim publik organizohet nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), në bashkëpunim me KRU "Prishtina" sh.a., me temën kryesore "Përcaktimi i Tarifave të Shërbimeve të Ujit 2026-2028".
Në prezantim do të marrin pjesë përfaqësues përgjegjës nga KRU "Prishtina" dhe analisti i tarifave nga ARRU.
Gjatë sesionit, KRU "Prishtina" do të paraqesë analizën dhe propozimet e saj për Procesin Tarifor 2026–2028, si dhe objektivat strategjike të kompanisë për periudhën e re tarifore.
Rikujtim: ARRU, si autoritet i pavarur rregullator, ka mandat të mbikëqyrë dhe rregullojë veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës.
Roli i saj është të sigurojë që qytetarët të kenë qasje në shërbime cilësore, efikase dhe të sigurta, në mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese, duke mbrojtur njëkohësisht mjedisin dhe shëndetin publik.
Ndërkohë, KRU "Prishtina", si ofruesi më i madh i shërbimeve të ujit në vend, ka për mision furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza për qytetarët e Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Graçanicës, Shtimes, Lipjanit, Podujevës dhe Drenasit, në përputhje me standardet ligjore dhe kërkesat e aksionarit.

SHPALLJE

SHTËPI/BANESA/ SHITBLERJE

Shes ose leshoj banesen me qira 41.50m, ne Ulpiane afer Shkolles Hasan Prishtina, banesa eshte ndertim i vjeter, ka nxemje qendrore, kati i II-të, info në tel: 044 740 110.

SHTËPI/BANESA/ ME QIRA

Lëshoj me qira banesën në Prishtinë në Bregun e Diellit. Banesa ka 60m2 e mobiluar kati i IV. Të inte resuarit të lajmërohën në Tel. 044/ 265 856.

Jap me qira banesën njëdhomëshe kati I III-të me nxe-mje qendrore, e përshtatshme edhe për zyrë, te Bulevardi Bill Klinton, nuk punoj me agjenci. Kontakti në tel 049/448 227.

LOKALE AFARISTE

Shitet lokali në qendër të Prishtinës, me sipërfaqe 65m2 me qira mujore 1200 euro për një muaj me kontrate afat gjate prej 8 - vitesh me mun dësi të ngritjes së çmimit për qira Çmimi i shitjes për lokal është 5700 euro për m2. Shitet shtëpia në Prishtinë, me sipërfaqe 5ari 35 m2 shtëpia e banimit 300 m2 me katër lokale të ndara prej shtëpisë të gjitha janë të lëshuara me qira për kohë të gjatë, çmimi 740. 000 euro. Shitet trualli në Çagllavicë, me sipërfaqe 22 ari buzë rrugës, i cili shërben vetëm për qëllime afariste çmimi 35.000 euro për ari. Shitet shtëpia në qendër të Graçanicës, me sipërfaqe 45 ari truall, me një shtëpi dy katëshe me sipërfaqe 160 m2. Çmimi 8.000 euro për ari. Shitet një shtëpi e vjetër me sipërfaqe 204 ari tokë në fshatin Skullan, kjo ndodhet ndër lagjen "Marigona Rrezidence", çmimi 120.000 euro gjithsej. Shitet shtëpia e vjetër në Graçanicë, me 13 ari + 2ha arë 12 ari tokë, çmimi 160. 000 euro. Info në tel: 044-406-400; 049-406-400.

TË TJERA

Edisjana Lokaj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit EDLUXSTORE me numër unik 811938250 Prishtinë.

HAPET TENDERI PËR PUNIME NË LOKALITETIN E NJOHUR ARKEOLOGJIK

Dresniku i mozaikëve unikë në kapitullin e radhës me 2.5 milionë euro

Këtu e 13 vjet më parë zbulimi i mozaikëve në Dresnik u bë sensacion botëror, prej atëherë ishte e ditur se ky lokalitet ka potencial dhe duhet të jetë i hapur për vizitorë, ndër vite vazhdoi të befasojë me gjetje e njëri prej hapave më me peshë deri më tash qe edhe shpronësimi. Tash janë hapur rrugët që ky lokalitet të hyjë në kapitullin e radhës: të shndërrohet në pikë turistike. Ministria e Kulturës ka hapur tenderin prej gati 2.5 milionë eurosh. Në projekt janë konkretizuar krejt elementet për zhvillimin e këtij lokaliteti që është nën mbrojtje të përhershme


Shaban Maxharraj

PRISHTINË, 18 NËNTOR – Mozaikët shumëngjyrësh të Dresnikut prej zbulimit të tyre, para më shumë se një dekade më parë, janë parë si potencial i madh i prezantimit të vlerave arkeologjike. Projekti për hapjen e tyre për vizitorë synon që lokaliteti arkeologjik i shekujve të parë të erës sonë krejt afër Klinës të shndërrohet në alamet pike turistike e reprezentative për vendin. Në një interval kohor prej tre vjetësh, ky lokalitet pritet të marrë vëmendje të madhe.

Ministria e Kulturës ka hapur tenderin me vlerë të parashikuar dy milionë e 479 mijë euro për të realizuar projektin e hartuar nga Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Fondacioni për Trashëgimi Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova). Bëhet fjalë për punimet rrethanore e infrastrukturore, ku përfshihet edhe mbuloja e mozaikëve unikë në këto anë. Pjesë tjetër është restaurimi i tyre që kërkon profesionalizëm të lartë.

"Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut – Klinë" mban titullin thirrja publike për kompanitë që mund të synojnë ta zbatojnë projektin.

Konstruksioni metalik pritet t'u bëjë strehë mozaikëve në mënyrë që të kenë mbrojtje nga kushtet atmosferike. Bëhet fjalë për mbetjet e pallatit kryesor të lokalitetit. Pjesët e tjera të kompleksit, që mendohet të ketë qenë vilë perandorake, do të jenë të hapura ndaj ambientit. Është ai që tashmë njihet si pallati i dytë bashkë me ndërtesën e tretë. Mbetjet e një pjese të murit rrethues e të kullës vrojtuese do të jenë në dispozicion të publikut po ashtu. Sipas projektit, ndërtesa multifunksionale do të ketë hapësira për stafin, një lloj galerie, një tip kafeneje e hapësira të tjera. Kurse



Me projekt, lokaliteti arkeologjik i Dresnikut ka krejt elementet që e bëjnë atë një lloj muzeu të hapur

amfiteatri i hapur do të shërbejë për aktivitete të ndryshme kulturore. Krejt kjo afër në hapësirë me gjelbërim e vendparkingje. Nëse projekti realizohet siç është paraparë, Dresniku shpejt do të shndërrohet në një atraksion më vete.

Arkitekti Nol Binakaj nga "CHwB Kosova", që bashkë me udhëheqësin e gërmimeve në Dresnik, arkeologun e Institutit Arkeologjik të Kosovës, Elvis Shala, kanë çuar përpara projektin, ka thënë se plani i ndërhyrjes bashkë me masterplanin janë finalizuar dhe implementimi është një lajm tejet i mirë.

"Në bazë të propozimit tonë tenderi e parasheh vetëm ndërtimin e strukturave të reja. Qasja jonë ka qenë që të bëhet lokaliteti i vizitueshëm. Është paraparë ndërtim konvencional që bëhet në Kosovë nga operatorët ekonomikë në vend. Konservimin e strukturave ekzistuese dhe mozaikëve, sipas të gjitha gjasave, do ta bëjnë stafi i Institutit Arkeologjik të Kosovës", ka thënë ai. Binakaj ka treguar se është projektuar çdo detaj në mënyrë që lokaliteti të jetë sa më i qasshëm për të gjithë vizitorët. Ideja ka qenë që edhe projekti për konservim profesional të mozaikëve dhe strukturave të tjera të financohet nga Fondi i Ambasadorit për Trashëgimi Kulturore i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por pak para përfundimit të projektit "Ruajtja e lokalitetit arkeologjik e Dresnikut", implementuesit janë njoftuar se financimi në kuadër të Fondit të Ambasadorit për Trashëgimi Kulturore është ndërprerë. Realisht qenë fondet e SHBA-së që kishin rikthyer vëmendjen te Dresniku i harruar qysh prej vitit 2019. Memorandum bashkëfinancimi për të përkrahur projektin "Ruajtja e lokalitetit arkeologjik e Dresnikut" midis Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Kulturës siguronte 150 mijë dollarë (141 mijë e 849 euro) në kuadër të Fondit të Ambasadorit për Trashëgimi Kulturore. Në anën tjetër, Ministria e Kulturës kishte ndarë 51 mijë e 830 euro.

Projekti që nisi në shtatorin e vitit 2023 zgjati deri në qershorin e vitit 2025. "CHwB Kosova" dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës si partnerë kanë aplikuar edhe për projektin për konservimin e mozaikëve dhe strukturave. Por Binakaj ka treguar se ende s'kanë marrë përgjigje.

Arkeologu që udhëheq gërmimet e hulumtimet shkencore në Dresnik, Elvisa Shala, të martën ka qenë i paqasshëm. Në mars të këtij viti ai kishte thënë se MKRS-ja prej fillimit ka treguar se do ta mbështesë këtë projekt deri në fund.

"Problemi kryesor ka qenë shpronësimi dhe ai është bërë. Tash kemi një projekt shumë të mirë e të detajuar", kishte thënë Shala. Sipas tij, kuadrot vendore mjaftojnë për të realizuar konservimin e mozaikëve dhe strukturave.

Lokaliteti i shekujve të parë të erës sonë që gjendet afër Klinës së voni është shpronësuar, gjë që u ka hapur rrugë edhe më shumë investimeve. Sipas hapave që janë ndërmarrë deri më tani, pritet që kjo hapësirë të jetë prej më tërheqëseve sa i përket trashëgimisë kulturore.

Vendimi i Qeverisë për shpronësim ishte parë tejet i rëndësishëm për lokalitetin arkeologjik, i cili që prej vitit 2016 është futur në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përhershme me perimetër 16.72 hektarë. Zonë e mbrojtur llogariten 64 hektarë. Por, shtetëzimi kap pak më shumë sesa dhjetë për qind të kësaj hapësire.

"Është hapi më i rëndësishëm deri më tash në arkeologji", kishte thënë Shala për shpronësimin e 7.8 hektarëve.


Procesi i shpronësimit të lokalitetit kishte nisur një ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes midis Ambasadës së SHBA-së në Kosovë dhe Ministrisë së Kulturës, e cila rikthen vëmendjen te Dresniku. Marrëveshja që nënshkruar më 26 shtator të vitit 2023, kurse në Qeveri vendimi që i ka hapur rrugë shpronësimit që votuar në ditën e 27-të të atij muaji.

Shpronësimi në Dresnik, që shtrihej në prona private, ka qenë një temë prejse doli në pah mozaiku unik më 2013, kur punimeve u printe arkeologu tash i pensionuar, Masar Valla. Asokohe njëra nga pronaret e tokës së gjetjes që u bë sensacion botëror do të tregohej e gatshme që prona e saj t'i nënshtrohej procesit të shpronësimit. Slagjana Shmiliq, bashkë me bashkëshortin e saj, Desko Srblak, kishin thënë se do t'u përshtateshin ligjeve në fuqi të Kosovës për shpronësimin e tokës së tyre.

Lokaliteti arkeologjik të Dresnikut rreth 1.5 kilometra në lindje të qytetit të Klinës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e cilëson si një prej lokaliteteve arkeologjike më të rëndësishme jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Në gërmimet e viteve 2012-2015 janë identifikuar disa monumente arkitekturore prej të cilave veçohet Aula me përmasa të mëdha.

"Kjo lloj Aule mund t'u përkasë vetëm pallateve të asaj kohe. Përveç madhësisë së objektit, ky monument veçohet për shkak të dyshemeve të tëra të mozaikut polikrom. Pallati është i vendosur në qendrën e këtij lokaliteti dhe gjithashtu është identifikuar muri rrethues me gjerësi 3.7 metra dhe 3 kulla që karakterizohen nga madhësia dhe trashësia e mureve. Brenda mureve është gjetur edhe një kompleks banimi në të cilin u identifikuan gjurmë të piktura murale të hipokausteve që dëshmojnë nivelin e lartë shoqëror, ekonomik dhe artistik të banorëve të këtij kompleksi", shkruhet në përshkrim. Po ashtu janë gjetur edhe shumë monedha të perandorëve të ndryshëm romakë të shekujve III dhe IV, si dhe disa copëza të shtatoreve të punuara nga mermeri.

© KOHA Ditore



Sipas projektit, ndërtesa, multifunksionale do të ketë hapësira për stafin, një lloj galerie, një tip kafeneje e hapësira të tjera. Kurse amfiteatri i hapur do të shërbejë për aktivitete të ndryshme kulturore. Krejt kjo afër në hapësirë me gjelbërim e vendparkingje

Shqipëria synon fuqizimin e turizmit dhe kulturës, rrit buxhetin në 76 milionë euro

TIRANË, 18 NËNTOR – Projektbuxheti për vitin 2026 për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të Shqipërisë synon forcimin e turizmit të qëndrueshëm, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e kapaciteteve krijuese dhe sportive në vend.

Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, ka thënë se buxheti total i MTKS-së për vitin e ardhshëm parashikohet në 7.4 miliardë lekë (rreth 76.5 milionë, që është rritje prej 20% krahasuar me vitin 2025.

"Ky projektbuxhet reflekton prioritetet tona strategjike për zhvillim afatgjatë dhe rritjen e ndikimit kulturor, ekonomik dhe social në vend. Investimi më i madh i dedikohet kulturës, por edhe turizmi, sporti dhe politikat rinore marrin fonde të konsiderueshme për zhvillim dhe përmirësim të kapaciteteve", ka thënë Gonxhja.

Sipas ministrit, shpërndarja e fondeve për sektorët kryesorë parashikon për kulturën 4.95 miliardë lekë (rreth 51.2 milionë euro), që përbën 67 për qind të buxhetit të Ministrisë, ose 19.4 për qind më shumë financim krahasuar me vitin 2025.

Për sektorin e turizmit projektbuxheti 2026 parasheh një fond prej 919 milionë lekësh (rreth 9,5 milionë euro), në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.

Për sportin janë paraparë 834,6 milionë lekë (rreth 8,62 milionë euro), me një rritje 32 për qind krahasuar me vitin e kaluar dhe për mbështetjen e rinisë do të financohen 285,8 milionë lekë (rreth 2,96 milionë €).

Ndërsa për shpenzimet e brendshme të ministrisë, projektbuxheti parashikon:

21,5 milionë euro për paga dhe sigurime e 27,3 milionë euro për shpenzime operative. Për investime kapitale janë 27,5 milionë euro.

Buxheti i Kosovës për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për sivjet është 86,3 milionë euro.



Forcimi i turizmit të qëndrueshëm, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i kapaciteteve krijuese dhe sportive në vend, janë synimet e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit me rritjen e buxhetit prej 20 për qind në krahasim me vitin e kaluar

ZBULIMI ARKEOLOGJIK NDRYSHON QASJEN NDAJ ZHVILLIMIT TË QENIES NJERËZORE

Besimet parahistorike në figurinën 12 mijë vjet të vjetër

Figurina që paraqet gruan dhe rosën mund të jetë njëri prej interpretimeve të panjohura deri më tash të një skene mitologjike. E zbuluar në veri të Izraelit, është artefakti më i hershëm i njohur në botë që tregon ndërveprim midis njeriut dhe një kafshe. Po ashtu është paraqitja më e hershme e njohur natyraliste e jo e stilizuar, e një gruaje në artin e Azisë Jugperëndimore

Will Dunham

WASHINGTON, 18 NËNTOR (REUTERS) - Një figurinë argjile rreth 12 mijë vjet e vjetër që është zbuluar në një zonë të fshatit parahistorik pranë Detit të Galilesë në Izraelin verior shfaq një grua dhe një rosë. Ky mund të jetë një nga interpretimet më të vjetra në botë të një skene mitologjike.

Hulumtuesit kanë thënë se figurina, e gjatë 3.7 centimetra, është zbuluar brenda një strukture gjysmërrethore guri me diametër 5 metra në një zonë të quajtur Nahal Ein Gev II. Fshati kishte qenë pjesë e kulturës natufiane të Azisë Jugperëndimore që ka parë transformimin parahistorik mes gjuetarmbledhësit nomad dhe komuniteteve të vendosura në agro-kulturë.

Është figurina më e hershme e njohur në botë që tregon ndërveprim midis njeriut dhe një kafshe, sipas Laurent Davin, kërkues pasdoktoral në arkeologji në Universitetin Hebraik të Jerusalemit dhe autor kryesor i studimit të botuar të hënën në revistën "Proceedings of the National Academy of Sciences". Po ashtu është paraqitja më e hershme e njohur natyraliste e jo e stilizuar, e një gruaje në artin e Azisë Jugperëndimore, ka thënë Davin.

Rosa është e pozicionuar mbi shpinën e gruas që rri ulur, me krahët e hapur në një pozicion çiftëzimi. Skena hedh dritë mbi sistemin e besimit të kulturës parahistorike, ka thënë arkeologu dhe bashkautori nga Universiteti Hebraik, Leore Grosman.

"E kemi interpretuar skenën e ndërveprimit si ilustrim i një çiftëzimi imagjinar mes shpirtit të një kafshe dhe njeriut. Kjo temë është mjaft e zakonshme në shoqëritë animistike në gjithë botën, në situata të veçanta, si në ëndrra erotike, vizione shamanike dhe mite", ka thënë Grosman.

Animizmi është një sistem besimi që në parim thuhet se gjërat në natyrë – organizmat e gjallë si bimët dhe kafshët, si dhe objektet jo të gjalla si gurët dhe lumenjtë – posedojnë një jetë shpirtërore.

"Vetë skena që paraqet një ndërveprim të seksualizuar midis një njeriu dhe një kafshe, është pjesë e një tradite të gjatë në mitologji. Imazhe të këtilla nuk e bartin gjithmonë kuptimin e parë. Shpesh simbolizojnë fertilitetin, besimet spirituale dhe shenjtërinë e jetës", ka thënë Natalie Munro, antropologe dhe bashkautore në Universitetin e Connecticutit. "Në plot mite gjatë historisë dhe kulturave, perëndi ose qenie, i shohin format hibride njeri-kafshë si dicka që përcjellin kuptime simbolike, jo domosdo aktivitet seksual real", ka thënë Munro.

Figurina duket se është shembulli më i vjetër i një skene mitologjike në Azinë Jugperëndimore dhe një nga më të vjetrat në botë, por është më e re, për shembull, se një skenë e dukshme mitologjike mes pikturave të Shpellës Lascaux në Francë, që datojnë rreth 18 mijë vjet më parë, kanë thënë studiuesit.

Figurina është gdhendur nga argjila e lënë për t'u tharë para se të piqet, për ta bërë të qëndrueshme dhe më pas është ngjyrosur me një pigment të kuq, gjurmë të të cilit kanë mbijetuar. Një gjurmë gishti e skulptorit shihet mbi figurinë.

Objekti tregon risi artistike për kohën e atëhershme. Skulptori ka përdorur dritëhijen për të krijuar një ndjesi thellësie dhe perspektive, metoda këto që do të lulëzonin shumë më vonë.

"Duke marrë parasysh mënyrën se si është modeluar, me theks në profilin e saj të majtë, ne e dimë se kjo figurinë ndoshta ishte ekspozuar në një vend të caktuar për të marrë dritë, nga dielli ose një oxhak, mbi profilin e saj të majtë, për të zbuluar lojën e dritës dhe hijeve që i jep jetë ndërveprimit midis rosës dhe gruas", ka thënë Davin.

Figurina të këtilla mund të kenë shërbyer si ornamente, objekte me veti mbrojtëse ose magjike apo si rekuizita për të treguar storie. Kjo mund të ketë qenë pjesë e një instalacioni skenik që banorët e fshatit kishin ardhur ta shikonin, ka thënë Davin.

Në një moment, ajo është varrosur në mbushjen e strukturës ku e gjetën studiuesit, së bashku me objekte të tjera me kuptim ritual, si një depo dhëmbësh njerëzorë dhe mbetjet e një fëmije.

Populli natufian ka qenë një ndër gjuetarmbledhësit e parë në Azinë Jugperëndimore që kanë adaptuar një stil jetese më pasive, një transformim dramatik që i ka paraprirë ardhjes së bujqësisë. Banorët e këtij fshati kanë gjuajtur gazela, kanë praktikuar zhvillimin e mjeshtërive si thurja dhe kanë mbledhur materiale të lëndës së parë si gurë flinti dhe gurë gëlqerorë.

Mbetjet e rosave nga gërmimi i zonës janë evidenca për gjuajtje, therje dhe përdorim puplash. Me sa shihet, skena e figurinës nuk lidhet me gjuajtjen.

'Aluzioni i këtij zbulimi është se stili pasiv i jetës ka prodhuar transformime të mëdha në strukturat shoqërore, edhe midis njerëzish, por edhe mes njerëzve dhe mjedisit rrethues, gjë që ka çuar pastaj në transformime të të treguarit të storieve, shprehjeve simbolike dhe teknikave artistike.

Marrë nga "Reuters". Përktheu: Sinan Berisha



Një figurinë argjile 12 mijë vjet e vjetër (majtas) e zbuluar në një zonë arkeologjike me pamje nga Deti i Galilesë në veri të Izraelit, i quajtur Nahal Ein Gev II; një rikonstruksion artistik i figurinës (djathtas). Imazhet u publikuan më 17 nëntor 2025. Laurent Davin dhe Vic Oh/ REUTERS



Studiuesit Natalie Munro dhe Laurent Davin shqyrtojnë figurinën prej argjile 12.000-vjeçare, e zbuluar në një zonë arkeologjike me pamje nga Deti i Galilesë në veri të Izraelit, i quajtur Nahal Ein Gev II, në Universitetin Hebraik të Jerusalemit në këtë fotografi pa datë, e publikuar më 17 nëntor 2025. Laurent Davin dhe Vic Oh/ REUTERS

RISA NË LEKSIKUN E ANGLISHTES, NDJEK TRENDËT

"Parasocial" është fjala e vitit në Fjalorin e Cambridgeit

Termi daton prej vitit 1956, kur sociologë amerikanë kanë vëzhguar teleshikuesit, teksa krijojnë marrëdhënie "parasociale" me personalitete të ekranit. Kryeredaktori Colin McIntosh ka thënë se së fundi është përdorur për ta përshkruar "një lloj marrëdhënieje mes një personi dhe një jopersoni, për shembull një personazhi të famshëm"

LONDËR, 18 NËNTOR (BBC) - "Parasocial" është fjala e vitit në Fjalorin e Cambridgeit, definuar si marrëdhënie që dikush e ndien midis vetes dhe një personi të famshëm që nuk e njeh. Një shembull që përfshin këtë dukuri është interesi parasocial që kanë shfaqur tifozët kur këngëtarja Taylor Swift dhe futbollisti amerikan Travis Kelce kanë bërë publike fejesën e tyre.

Termi daton prej vitit 1956, kur sociologë amerikanë kanë vëzhguar teleshikuesit, teksa krijojnë marrëdhënie "parasociale" me personalitete të ekranit.

Kryeredaktori Colin McIntosh ka thënë se së fundi është përdorur për ta përshkruar "një lloj marrëdhënieje, mes një personi dhe një jopersoni, për shembull një personazhi të famshëm".

"Në fillim është krijuar si një fjalë akademike dhe ishte e kufizuar në domenin akademik për një kohë goxha të gjatë. Vetëm gjatë kohëve të fundit ka bërë një ndërrim në gjuhën popullore dhe është një nga ato fjalët që janë ndikuar prej rrjeteve sociale", ka thënë ai.

Shembuj të tjerë që jep fjalori përfshijnë: albumin e ndarjes së Lily Allenit "West End Girl", që ka çuar në një interes parasocial në jetën e saj dashurore; si dhe urgjenca e marrëdhënieve parasociale me robotë të Inteligjencës Artificiale, që paraqet njerëzit duke i trajtuar si bashkëbisedues, miq, apo edhe partnerë romantikë.


Natyra rrëfyese e moderatorëve të podkasteve thuhet se i ka zëvendësuar miqtë realë dhe ka nxitur marrëdhënie parasociale. Fjalori ka vënë re një valë kërkimesh që njerëzit e lypnin fjalën, pasi influenceri nga YouTube, "IShowSpeed" e ka bllokuar një tifoz të fiksuar si "parasociali numër 1" i tij.

Fjala është krijuar për herë të parë nga sociologët e Universitetit të Chicagos, Donald Horton dhe Richard Wohl, që kanë vëzhguar teleshikuesit që përfshihen në marrëdhënie "parasociale" me personazhe televizive, duke ngjasuar me ato që kanë krijuar me familje dhe me miq të vërtetë.

Ata kanë vënë re se si mediumi i televizionit, që po përhapej shumë shpejt, kishte sjellë fytyrat e aktorëve drejtpërdrejt në shtëpitë e shikuesve, duke i bërë si instalime në jetët e njerëzve.

"Nuk jemi ne që gjykojmë çka është fjalë e mirë, çka është e keqe dhe a është e vlefshme – mjafton ta kalojë testin e kohës dhe njerëzit ta përdorin gjatë gjithkund", ka thënë redaktorja Jessica Rundell.

Fjalë të reja që kanë hyrë në Fjalorin e Cambridgeit janë: "skibidi", "delulu" dhe "tradwife".



Miliona tifozë u referohen teksteve rrëfyese të Taylor Swiftit për "dating", zemërthyerje dhe dëshira, duke çuar në lidhje "parasociale me yje të famshme", kanë thënë psikologët (Foto: Getty Images)



Eminemi padit kompaninë australiane “Swim Shady”

Reperi amerikan, Eminem, ka ndërmarrë veprime ligjore kundër një kompanie australiane të veshjeve të plazhit të quajtura “Swim Shady”, duke thënë se emri i saj është shumë i ngjashëm me pseudonimin e tij, Slim Shady.

Në shtator, Eminemi, emri i vërtetë i të cilit është Marshall B. Mathers III, paraqiti një peticion në Zyrën Amerikane të Markave, duke kërkuar që t’i anulohet marka tregtare që i ishte dhënë kompanisë. Sipas ligjit amerikan, kompania duhet të përgjigjet ndaj peticionit deri javën e ardhshme.

Avokatët e reperit akuzojnë markën me bazë në Sidney se ka krijuar ngjashmëri të rreme me Eminemin.

Reperi 53-vjeçar u bë i famshëm në vitin 2000 me publikimin e hitit “The Real Slim Shady” këngë që i solli edhe një çmim “Grammy” për përformancën më të mirë solo në zhanrin rep.

Sipas rregullatorit të bizneseve në Australi, kompania në fjalë u regjistrua në shtator të vitit 2023, fillimisht me emrin “Slim Shade”. Ajo shet çadra portative plazhi, çanta dhe aksesorë të tjerë për plazh. Më herët këtë vit, marka aplikoi për mbrojtje tregtare në SHBA, dhe u miratua. Pak kohë më pas, ekipi ligjor i reperit paraqiti peticion për anulimin e saj.

Dokumentet gjyqësore tregojnë se Eminemi e kishte regjistruar markën “Slim Shady” në vitin 1999 në kohën e publikimit të albumit me të njëjtin emër. Avokatët e tij thonë se emri është bërë i famshëm dhe lidhet ekskluzivisht me karrierën e tij muzikore.

Firma juridike e specializuar në pronësi intelektuale “Meyer West IP” është listuar si përfaqësuese ligjore e “Swim Shady”.

Vitin e kaluar, një gjykatë australiane rrëzoi një vendim të mëhershëm që thoshte se këngëtarja amerikane, Katy Perry, kishte shkelur markën tregtare të stilistes australiane “Katie Perry”.

Stilisja, e cila shiste veshje me emrin e saj të lindjes, kishte akuzuar këngëtaren për shkelje të të drejtave të autorit.

George Clooney: Mësimet më të mëdha i mora nga dështimet

Aktori 64-vjeçar ka shijuar sukses të madh në Hollywood, duke u bërë një nga emrat më të njohur dhe më të paguar të industrisë së filmit. Por George Clooney thotë se karriera e tij është ndërtuar po aq edhe mbi dështimet, përfshirë këtu edhe filmin e vitit 1997, “Batman and Robin”.

I pyetur se nga cili projekt ka mësuar më së shumti, Clooney, i cili në atë film luajti përkrah Arnold Schwarzeneggerit, Uma Thurmanit dhe Alicia Silverstoneit, i tha revistës People: “Batman and Robin! Prej atij filmi mësova shumë. Nuk mëson nga suksesi, mëson nga dështimi, dhe pastaj gjatë rrugës duhet t’i gjesh zgjidhjet. Prandaj është i dobishëm.”

Clooney e portretizoi Batmanin në filmin e regjisorit Joel Schumacher, i cili u prit me kritika kryesisht negative. Aktori ka qenë i hapur edhe më herët për pakënaqësinë ndaj interpretimit të tij në këtë projekt.

Në një intervistë për The Hollywood Reporter në vitin 2019, ai tha: “Nuk isha mirë në atë film, dhe ai nuk ishte një film i mirë. Ajo që mësova nga ai dështim ishte se duhej të mësoja sërish mënyrën se si punoja. Nuk isha më thjesht një aktor që merrte një rol; mbaja përgjegjësi për vetë filmin.”


Si rezultat, ai vendosi të zgjidhte projekte më të kujdesshme, si Three Kings, Out of Sight dhe O Brother, Where Art Thou?

Më herët gjatë vitit, Clooney ka treguar se nuk është më në “garën për sukses”. Ai thotë se tashmë ka bërë karrierën e tij dhe po i jep përparësi familjes.

Ylli i Hollywoodit, i cili me bashkëshorten Amal ka binjakët 8-vjeçarë, Ella dhe Alexander, i tha Extra:

“Nuk jam më në atë garë të ethshme për të pasur sukses. Karrierën e kam bërë në shumë drejtime dhe gjërat janë qetësuar, ndaj mund të jem më shumë në shtëpi me fëmijët. Është argëtuese, dhe jam ende mjaft i ri për të vrapuar pas tyre… për pak kohë edhe mund ta bëj”.

George dhe Amal së fundmi shënuan 11-vjetorin e martesës. Aktori zbuloi se këtë përvjetor e festuan me një darkë të qetë. Ai ka thënë më herët se suksesin e tij e sheh si kombinim mes punës dhe fatit. Për AARP, Clooney u shpreh: “Mësimi i vetëm i jetës është të vësh bast mbi veten. Kur të vijnë mundësi, duhet të veprosh. Kam bërë shumë fat në jetë, por besoj edhe se njeriu krijon vetë mundësi për fat. Sa më shumë mundësi krijon, aq më shumë prej tyre i qëllon”.



Bailey: Kishte shumë role që mendoja që nuk mund t’i luaja për shkak të orientimit tim seksual

Aktori 37-vjeçar, i cili së fundmi u bë burri i parë homoseksual që fiton çmimin “Sexiest Man Alive” nga revista People, shprehet i zhgënjyer që aktorët dhe aktoret aspirues vazhdojnë t’i shohin ambiciet e tyre të zbehura nga faktorë jashtë kontrollit të tyre, si raca, klasa apo seksualiteti.

Jonathan Bailey, i cili është udhëheqës i organizatës “Just Like Us”, që punon me të rinjtë LGBT në shkollat e Mbretërisë së Bashkuar – i tha “Sky News”: “Kjo është përtej seksualitetit, është raca, është klasa, është prej nga vjen. Të gjithëve na jepen narrativa kufizuese nga të cilat duhet të çlirohemi. Mendoja jo vetëm se nuk do të mund t’i luaja këto role për shkak të seksualitetit tim, por edhe se nuk do të mund të bëja Shakespeare sepse nuk kam shkuar në shkollë aktrimi. Këto janë tregimet që duhet t’i rikujtojmë, se të ngrihesh, të jesh i sigurt të thuash kush je vërtet, dhe të jesh i pambuluar emocionalisht në atë moshë…”

Ndërkohë, Jonathan ka zbuluar më herët se “pothuajse nuk u paraqit fare në audicion” për Bridgerton.

Aktori ka luajtur në serialin e suksesshëm të Netflix që nga viti 2020, por në fakt, ai ishte i gatshëm të mërrte një pauzë nga karriera para se të angazhohej në projekt.

Megjithatë, qëndrimi i Jonathanit ndryshoi krejtësisht pasi lexoi skenarin.

Ai tha: “Mbaj mend që thashë me vete: ‘Uau, kjo do të jetë gjigante’”.

Jonathan tregon se xhirimet e Bridgerton kanë qenë një eksperiencë “përfshirëse në çdo drejtim”, dhe për këtë arsye ai e ka mirëpritur rikthimin në rrënjët e teatrit vitet e fundit.

“Rikthimi në teatër, puna me njerëz që i njoh, më ka ndihmuar”.



Cruise merr “Oskarin” e parë në karrierë



Superylli amerikan i filmit, Tom Cruise, ka marrë statujën e tij të parë të “Oscarit” në karrierë. Aktori 63-vjeçar u nderua me çmim nderi në ceremoninë vjetore “Governors Awards” në Hollywood, bashkë me këngëtaren dhe filantropisten Dolly Parton, koreografen Debbie Allen dhe dizajnerin e njohur të prodhimit, Wynn Thomas.

“Bërja e filmave nuk është ajo që bëj, është ajo që jam”, tha Cruise të dielën, teksa mbante fjalimin e pranimit të çmimit të shumëpritur të Akademisë, duke folur për dashurinë e tij ndaj kinemasë.

Ylli i “Top Gun” dhe “Mision Impossible” nderoi krijuesit e filmave, para dhe pas kamerës, me të cilët ka punuar gjatë karrierës së tij 45-vjeçare, si dhe foli për fuqinë që filmi ka për publikun. Në momentin që u ngjit në skenë, Cruise u prit me duartrokitje të gjata derisa të pranishmit qëndruan në këmbë. Në publik ishin figura të mëdha të industrisë, përfshirë Steven Spielberg, Leonardo DiCaprio dhe Jerry Bruckheimer. Çmimin ia dorëzoi regjisori Alejandro G.Inarritu, i cili po punon në filmin e ardhshëm me Cruisen në rolin kryesor.

“Kinemaja më çon nëpër botë”, tha aktori. “Më ndihmon të vlerësoj dhe respektoj dallimet. Në kinema qeshim bashkë, ndjejmë bashkë, shpresojmë bashkë, ëndërrojmë bashkë. Kjo është fuqia e kësaj forme arti dhe kjo është arsyeja pse ka rëndësi për mua”, ka thënë ai.

Cruise debutoi në film në vitin 1981 dhe më herët ishte nominuar katër herë për “Oscar”: për aktorin më të mirë me “Born on the Fourthy of July” dhe “Jerry Maguire” si aktor dytësor në “Magnolica” si dhe si producent i “Top Gun: Maverick”. Bordi i Guvernatorëve të Akademisë e zgjodhi Cruisen për “angazhimin e jashtëzakonshëm ndaj komunitetit të filmbërjes”, njoftoi organizata.

Cruise tha në fjalimin e tij se kinemaja ia kishte zgjeruar botën shumë më tepër sesa ajo që njihte në fëmijëri. “M’i hapi sytë. Ma hapi imaginatën për mundësinë se jeta mund të zgjasë shumë përtej kufijve që besoja atëherë”.

Aktori, i njohur për aktrimin në skenat e rrezikshme, ka qenë edhe një mbrojtës i zjarrtë i kinemasë në një kohë kur platformat streaming dhe rrjetet sociale po garojnë për kohën e shikuesve.

“Dua ta dini se do të bëj gjithmonë gjithçka që mundem për ta ndihmuar këtë art, për të mbështetur zërat e rinj, për të mbrojtur atë që e bën kinemanë të fuqishme, shpresoj, pa shumë eshtra të thyer”, shtoi ai me humor.

Më herët gjatë vitit, Cruise raportohej se do të nderohej nga presidenti amerikan Donald Trump në listën e tij për çmimet e “Kennedy Center Honors”, por aktori thuhet se kishte refuzuar për shkak të angazhimeve kohore.

Kurat natyrale për kollin dhe frymëmarrjen

Edhe gjatë stinës së pranverës organizmi ynë vazhdon betejën me kollën, rrufën dhe problemet e rrugëve të frymëmarrjes.

Kolla nuk duhet anashkaluar asnjëherë sepse jo vetëm që prish stilin e jetës, por shkakton dëme fizike dhe shëndetësore.

Më poshtë do të gjeni disa kura të thjeshta si të shpëtoni nga kolla dhe problemet e tjera të uljes së temperaturave apo alergjive.



Mjalti

Prej shekujsh, mjalti përdorej kundër kollës dhe fytit të irrituar.

Kolla e thatë luftohet edhe me mjaltë dhe lëng rrushi, ose me një gotë qumësht me mjaltë përpara gjumit.

Ju mund të përzieni edhe lëng limoni me mjaltë në një gotë me ujë të ngrohtë dhe pini atë deri në tri herë në ditë.

Farat e linit

Nëse kolla juaj është e përkeqësuar, hidhni tri lugë me fara lini në një filxhan me ujë dhe ziejini së bashku.

Kur uji të nisë të trashet, kullojeni dhe lëngun përzieni me tre lugë lëng limoni dhe mjalti respektivisht. Më pas sa herë që të goditeni nga kolla merrni nga një lugë të kësaj përzierje magjike.

Xhenxhefili

Për një kollë të thatë, zgjidhni xhenxhefilin, hidhni pak kripë dhe përtypeni për disa minuta.

Kolla luftohet edhe me çaj xhenxhefili që përgatitet duke e zier atë në ujë deri sa pjesa më e madhe e tij të avullojë. Kullojeni lëngun, shtoni një lugë mjaltë dhe pini atë të ngrohtë

Çaji i trumzës

Përgatisni çajin e trumzës duke shtuar dy lugë me gjethe të shtypura trumëze në çajnik të mbushur me ujë dhe duke e zier për 10 minuta.

Pasi ta keni kulluar, shtoni mjaltë dhe limon. Të tria së bashku kanë fuqi të mëdha shëruese.

Çaj me mjaltë dhe piper të zi

Nëse vuani nga kolla e pjekur ose ajo me sekrecione, provoni çajin me mjaltë dhe piper të zi.

Ky i fundit stimulon qarkullimin dhe çlirimin e sekrecioneve, dhe mjalti ndalon kollën.

Përdorni një lugë çaji me piper të zi dhe dy lugë gjelle me mjaltë. Përziejeni në një gotë me ujë të nxehtë. Lërini të qëndrojnë së bashku për 15 minuta, kullojeni lëngun dhe pini atë.

Pini lëngun e limonit

Merrni një copë limoni. Spërkateni me piper të zi dhe kripë dhe pini lëngun magjik që ofron një shërim të menjëhershëm.

Bajamet

Merrni një lëng portokalli, shtoni disa lugë me bajame të shtypura ose pluhur dhe pini kundër kollës.

Qepët

Me qepët mund të bëni një shurup fantastik. Përzieni lëngun e limonit, mjaltin, qepën e grirë dhe ziejeni në një tenxhere me ujë të nxehtë, për 2 orë. Kullojeni lëngun dhe pini një lugë gjelle prej tij çdo një orë.

Karafili

Përzieni erëzën e karafilit me mjaltin dhe ruajeni gjatë natës në frigorifer. Në mëngjes hiqni karafilat e thatë dhe konsumoni një lugë nga mjalti i mbetur. Dhimbja në fyt do të shërohet dhe inflamacioni do të zvogëlohet.

Lëngu i karotës

Përgatisni lëng të freskët karotë duke shtrydhur katër karota dhe përzier lëngun me ujë. Këtë lëng duhet ta pini katër herë në ditë.

Jamballi

Kjo bimë që njihet edhe me emrin Likuiricia lufton kollën sepse zbut sekrecionet dhe ofron qetësim nga spazmat e bronshitit. Mjaftojnë dy lugë çaji nga lëngu i jamballit në ujë të ngrohtë./AgroWeb

Dobitë shëndetësore të konsumimit të vezëve në mëngjes

Shumë njerëz mendojnë se produktet si tërshëra janë zgjedhja më e mirë për vaktin e parë të ditës, por ky është një koncept i gabuar.

Vezët janë të shijshme dhe duhet të jenë pjesë e vaktit të mëngjesit. Ato përmbajnë shumë proteina dhe ndihmojnë në uljen rriskut të shtimit në peshë në krahasim me vaktet e tjera që shumica e njerëzve zgjedhin si mëngjes.



Vezët ju bëjnë të ndiheni të ngopur për më gjatë

Proteina dhe yndyra te vezët ndihmojnë në ruajtjen e niveleve të energjisë, duke ju mbajtur të ngopur për më gjatë.

Ndihmojnë në humbjen e peshës

Studimet kanë treguar se njerëzit që hanë vezë për mëngjes kanë më shumë gjasa të humbin peshë sesa ata që hanë bukë apo diçka tjetër për mëngjes.

Janë një burim i madh i proteinave

Vezët janë një nga burimet më të mira të proteinave, që do të thotë se ato përmbajnë të gjitha aminoacidet thelbësore që duhet të marrim nga regjimet tona ushqimore.

Rekomandohet të konsumoni të paktën një vezë në ditë për të pasur një regjim ushqimor të ekuilibruar

Vezët janë të lira

Në krahasim me ushqimet e tjera me proteina të larta, si mishi i kuq, vezët me janë më të lira dhe mund të gjenden lehtësisht kudo.

Nuk e përkeqësojnë kolesterolin

Edhe pse është e vërtetë që vezët përmbajnë një sasi të konsiderueshme të kolesterolit, studimet e fundit tregojnë që kjo nuk ndikon në përkeqësimin e niveleve të kolesterolit.

Ndihmojnë në zhvillimin e trurit dhe kujtesës

Vezët përmbajnë kolinë, një lëndë ushqyese që stimulon zhvillimin dhe funksionin e trurit. Gjithashtu konsumi i tyre përmirëson kujtesën dhe vigjilencën.

Mbrojnë shikimin tuaj

Dy antioksidantë të pranishëm tek veza si luteina dhe zeaxanthin, lidhen me mbrojtjen e syve nga dëmtimet ndaj ekspozimit nën rrezet e dëmshme të diellit. Gjithashtu konsumi i tyre mund të ulë edhe rrezikun e mundësisë për të zhvilluar katarakt në pleqëri. /AgroWeb.org

HOROSKOPI

Dashi (21.03 – 19.04)

Hëna e Re sot ju jep një mundësi të vlefshme për të vendosur qëllime të reja që lidhen me financat dhe përgjegjësitë tuaja. Merrni pak kohë për të reflektuar se si po i trajtoni borxhet, pronat e përbashkëta apo çështjet që lidhen me trashëgimitë. Pyeteni veten nëse po i menaxhoni me qetësi dhe organizim, apo nëse ka hapësirë për të përmirësuar mënyrën si silleni me këto detyrime.

Demi (20.04 – 20.05)

Sot keni shansin më të mirë të vitit për të përmirësuar marrëdhëniet personale dhe profesionale. Mendoni si mund t'u jepni më shumë stabilitet dhe harmoni. Një gjest i vogël nga ju mund të sjellë ndryshime të mëdha.

Binjakët (21.05 – 20.06)

Hëna e Re ju fton të rishikoni qëndrimin ndaj punës dhe detyrave të përditshme. Pyesni veten nëse po e shihni punën si barrë apo si mundësi. Një mënyrë e re e organizimit mund t'ju lehtësojë shumë.

Gaforrja (21.06 – 22.07)

Sot mendoni për ekuilibrin mes punës dhe kohës për veten. A po i jepni vetes hapësirë për argëtim, sport apo shoqëri? Pak më shumë kohë për veten do t'ju sjellë energji të reja.

Luani (23.07 – 22.08)

Hëna e Re prek shtëpinë dhe familjen tuaj, duke ju shtyrë të mendoni për marrëdhëniet familjare. Mendoni çfarë mund të përmirësoni në shtëpi për të sjellë më shumë paqe. Edhe një ndryshim i vogël mund të krijojë harmoni.

Virgjëresha (23.08 – 22.09)

Kjo ditë ju ndihmon të analizoni mënyrën si komunikoni me të tjerët. Pyeteni veten nëse po dëgjoni me vëmendje apo thjesht prisni radhën tuaj për të folur. Përmirësimi i këtij aspekti do të forcojë marrëdhëniet tuaja.

Peshorja (23.09 – 22.10)

Hëna e Re është momenti ideal për të rishikuar mënyrën si i menaxhoni financat dhe pasuritë. Shikoni nëse shpenzimet tuaja ju ndihmojnë në përditshmëri apo ju rëndojnë. Mund të gjeni një ritëm më të qëndrueshëm financiar.

Akrepi (23.10 – 21.11)

Hëna e Re në shenjën tuaj ju jep energji të fortë për t'u fokusuar te vetja. Mendoni për imazhin që i paraqisni botës dhe si doni të shfaqeni. Është momenti për një filim të freskët

Shigjetari (22.11 – 21.12)

Sot është koha të mendoni për besimet që udhëheqin vendimet tuaja. Pyesni veten nëse disa prej tyre duhen rishikuar apo thelluar. Një qartësi e re mendore mund t'ju hapë rrugë të reja.

Bricjapi (22.12 – 19.01)

Hëna e Re ju fton të mendoni për miqësitë dhe lidhjet shoqërore. Reflektoni cilët njerëz ju mbështesin dhe cilët ju mungojnë. Mund të jetë koha për të forcuar disa lidhje apo për të krijuar të reja.

Ujori (20.01 – 18.02)

Kjo energji ju shtyn të mendoni për karrierën dhe drejtimin ku po shkoni. Pyesni veten si silleni me autoritetet dhe si ndikon kjo në rrugëtimin tuaj. Sot mund të vendosni objektiva të rëndësishme për të ardhmen.

Peshqit (19.02 – 20.03)

Hëna e Re ju nxit të zgjeroni dijen dhe përvojat tuaja. Mendoni çfarë mund të mësoni ose përjetoni që t'ju pasurojë më shumë. Një hap i vogël drejt dijes mund të hapë horizonte të reja për ju.

Aro Muriq flet për top-trajnerët që i kishte dhe për vendimin që ta përfaqësojë Kosovën



PRISHTINË, 18 NËNTOR (KD) – Portieri i parë i Kosovës, Arijanet Muriq, ka dhënë një intervistë "prezantuese" për faqen zyrtare të Sassuolos. Te klubi i Serie A, portieri 27-vjeçar është i huazuar nga Ipswich Towni. Muriq po vlerësohet për paraqitje në kampionatin italian. Ai ndihet shumë mirë te Sassuolo, ndërsa ka thënë se e ka njohur klubin nga periudha që Nedim Bajrami e kishte në të. Muriq ka treguar se Bajramin e ka shok të fëmijërisë.

Aro Muriq ka treguar se edhe njëri prej trajnerëve te Kosova kishte të kaluar në klub dhe i ka thënë se Sassuolo do të jetë i duhuri për të.

"Nuk kam pritur që do të jetë kaq bukur, ndërsa më pëlqen sidomos energjia e njerëzve. Është gjë pozitive", ka thënë shtatlarti Muriq.

Ai ka lëvizur shumë gjatë karrierës. I lindur në Zvicër, Aro Muriq ishte si fëmijë te skuadra si Zurich e Grasshopper. Më pas u transferua te Manchester City. Kishte periudha huazimi te NAC Breda, Nottingham Foresti, Girona, Willem II, Adana Demirspor. Më pas u transferua te Burnley, tek Ipswich Town dhe tani është te Sassuolo.

Gjatë karrierës ka punuar me top-trajnerë. Pep Guardiola e Vincent Kompany janë dy prej tyre.

"Mund të them vetëm gjëra të mira për Pep Guardiolan. Ai është trajner cilësor që u jep lojtarëve të rinj shumë mundësi dhe i shtyn përpara ata. Shkova te NAC Breda huazim për disa ndeshje. Ishte klub partner i Manchester Cityt. Më pas Claudio Bravo u lëndua dhe më ftuan të kthehem te Manchester City. Kam pasur përvojë të mirë, ndërsa e kam luajtur një ndeshje. I kam lënë përshtypje të mira trajnerit të portierëve, që më pas më transferoi te Burnley. Ishte përvojë e shkurtër por intensive dhe isha i lumtur që u ktheva te Manchester City", ka thënë Aro Muriq për faqen zyrtare të Sassuolos.

Tek Adana në Turqi, Muriq për trajner e kishte Vincenzo Montellan, selektorin aktual të Turqisë.

"Mbaj mend që Montella më nxori jashtë në ndeshjen e parë të tij. Ishte e vështirë për mua të kthehem në ekip pasi nuk kam pasur raport të mirë me të në fillim. Por pas një kohe kemi kaluar më mirë. Kemi pasur lidhje të mirë dhe edicion të mirë. Kështu që çdo gjë shkoi mirë, sidomos me Montellan. Mendoj që Montella është trajner i mirë, përndryshe nuk do të ishte selektor i Turqisë. Mund të them vetëm gjëra pozitive për të. Jam ende në kontakt me Mario Balotellin, kemi jetuar në një vend. Ai gjithnjë më ka thënë 'eja në Itali, eja në Itali'. Dhe më në fund jam këtu. Balotelli më ka thënë vetëm gjëra pozitive. Ai e do Italinë. Jam i lumtur që jam këtu dhe ai nuk më ka gënjyer".

Muriq ka luajtur së bashku me trajnerin aktual të Bayernit, Vincent Kompany te Manchester City. Thotë se ishin shokë. Kur Kompany u largua nga City për tek Anderlechti, nga gjiganti anglez u largua edhe Muriq. Një ditë Kompany i telefonoi dhe e pyeti se ku është.

"Më tha se do të shkonte te Burnley dhe më pyeti nëse dëshironja edhe unë të shkoja. Unë iu përgjigja pozitivisht. Në atë moment kisha edhe oferta tjera, por ishte e qartë ku do të kaloja kur më thirri ai. Dhe kemi pasur një edicion të shkëlqyer në ligë. Kemi vendosur rekorde. Më pas kaluam në Premier League. Ishte më vështirë, por njëjtë si në kohën kur ishte lojtar, ai ishte gjithnjë serioz dhe strikt. E mbaj mend që analizonim secilin sulmues në dhomën e zhveshjes. Si trajner ai është i shkëlqyer. Që nga ora shtatë e mëngjesit deri në 10 të natës ai ishte në zyrë duke punuar. Ai është trajner fantastik, i jashtëzakonshëm", ka thënë Aro Muriq.

Aro ka thënë se mund të përshtatet në secilin ekip dhe në çdo gjë që ka të bëjë me futbollin.

Para se të bashkohej me Kosovën ai luajti dy ndeshje me U21 të Malit të Zi.

"Jam rritur në Zvicër. Kam shokë atje dhe e kam kaluar gjysmën e jetës në Zvicër. Kam zgjedhur ta përfaqësoj Kosovën për shkak të prindërve të mi. Nëna ime është nga Mali i Zi, ndërsa babai shqiptar. Dëshira e tij ishte që unë të luaja për Kosovën. Qartë se kam zgjedhur Kosovën. Nuk jam pishman për vendimin. Jam shumë i lumtur që luaj për Kosovën. Por natyrisht, e dua edhe Zvicrën. E kam familjen time atje, nënën, motrën, vëllain e vogël. Të gjithë shokët. Çdo ditë që e kam të lirë kthehem dhe i vizitoj. Zvicrën, Zurichun, i konsideroj shtëpi timen. E dua Zvicrën", ka theksuar Muriq.

Bunjaku thotë se Kosova do të jetë forcë në turne të mëdhenj

PRISHTINË,18 NËNTOR (KD) - Ish-futbollisti i Zvicrës dhe i Kosovës, Albert Bunjaku, ka thënë se Kosova do të jetë përfaqësuese e fortë në vitet e ardhshme, përfshirë edhe në turne të mëdhenj të futbollit.

"Kosova është dicka që mund të presim ta shohim në vitet e ardhshme", ka thënë Bunjaku në një intervistë për "Blue Sport", të martën.

Ish-qendërsulmuesi beson në të ardhme të ndritur për futbollin kosovar.

"Jam i bindur se do të ketë një tjetër rritje në vitet e ardhshme. Zhvillimi që është nisur nuk është ende i plotë. Kosova me siguri do të jetë një forcë që duhet të llogaritet në vitet e ardhshme, përfshirë edhe në turne të mëdhenj", ka theksuar Bunjaku.

Ai kishte vendosur t'i bashkohej Kosovës pas gjashtë paraqitjeve me Zvicrën. Bunjaku, tani 41-vjeçar, ishte pjesë e "helvetikëve" në Kupën e Botës 2010, duke bërë një paraqitje të shkurtër kundër Kilit.

Ai tha se vendimin për të përfaqësuar Kosovën në moshën 32-vjeçare e kishte marrë me zemër.

Bunjaku vazhdon të jetë pjesë e futbollit kosovar. Tani e kryen detyrën e selektorit të Kosovës U19.

Bunjaku beson se dy lojtarët e Hoffenheimit, Leon Avdullahu dhe Albian Hajdari, zgjodhën me vetëdije të paraqiten për Kosovën. Ardhja e Hajdarit dhe Avdullahut ka rritur nivelin e lojës së Kosovës, thotë ai.

"Kosova është zhvilluar jashtëzakonisht shumë gjatë viteve. Unë besoj se në të ardhmen të rinjtë me shtetësi të dyfishtë nuk do të zgjedhin më thjesht Zvicrën, Gjermaninë ose një përfaqësuese tjetër në vend të Kosovës, siç mund të ketë ndodhur në të kaluarën", është shprehur Bunjaku.

Në fakt, gjithnjë e më shumë të rinj me shtetësi të dyfishtë po zgjedhin të luajnë për Kosovën gjë që, sipas Bunjakut, kontribuon në zhvillimin sportiv të vendit.

Që nga viti 2016, Kosova është anëtare e UEFA-s dhe FIFA-s.

Më 3 qershor 2016, Kosova luajti miqësore kundër Ishujve Faroe dhe fitoi 2:0. Bunjaku u bë golashënuesi i parë i Kosovës pas pranimit.

Tani si përzgjedhës i Kosovës U19, Bunjaku kërkon gjithashtu talente në të gjithë Evropën.

"Është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne t'i identifikojmë talentet herët dhe që lojtarët e rinj të kuptojnë se po bëjmë një përpjekje



për t'i rekrutuar ata. Të bindësh një lojtar që t'i bashkohet Kosovës nuk është aspak e vështirë sot sa ishte në kohën time", ka thënë Bunjaku.

Fitore e madhe e Bashkimit në Francë

DIJON, 18 NËNTOR - Bashkimi ka vazhduar me paraqitje impresive në FIBA Europe Cup.

Pas dy fitoreve në Prizren, Bashkimi të martën mbrëma fitoi edhe në Francë. Skuadra prizrenase e mposhti Dijonin me rezultatin 93:84.

Bashkimi tani i ka tri fitore e tri humbje, sa edhe Dijoni.

Cibona i ka tri fitore e dy humbje, ndërsa Reggiana dy fitore e tri humbje. Cibona e Reggiana takohen të mërkurën prej orës 18:30 në Zagreb. Vetëm më pas do të dihet se kush do të avancojë prej Grupit J të stinorit të rregullt.

Tutje avancojnë fituesit e grupeve dhe gjashtë përfaqësueset më të mira të pozitës së dytë prej dhjetë grupeve sa janë gjithsej.

Bashkimi para një jave fitoi 77:76 ndaj Reggianas italiane në "Sezai Surroi". Dy javë më parë në arenën e njëjtë fitoi 89:69 ndaj skuadrës së njohur kroate, Cibona.

Të martën në Dijon, Bashkimi nisi shkëputjen në çerekun e dytë, ndërsa e vazhdoi në të tretin. Në çerekun e katërt vetëm e konfirmoi fitoren e madhe evropiane.

Isaiah Cousins dhe De'Quon Lake udhëhoqën Bashkimin. Cousins i kishte 20 pikë, gjashtë kërcime e pesë asistime. Lake ndeshjen e përfundoi me 17 pikë e katër kërcime. Por nuk e kishte asnjë dështim në gjuajtje.



Plot 20 pikë i kishte Jan Palokaj, që shtoi edhe tri asistime e dy kërcime. Ndërkohë kontribut të madh kishte edhe Lejson Zeqiri me 12 pikë, pesë kërcime e dy asistime.

Bashkimi për herë të parë po garon në FIBA Europe Cup, përkatësisht në skenën evropiane. Dhe kampanja e deritashme, që mund të vazhdojë, ishte shumë e suksesshme.

Peja mposhtet thellë në Varshavë

Peja e ka luajtur të martën mbrëma ndeshjen e radhës në ENBL.

Në Varshavë të Polonisë, Peja pësoi nga Dziki Varshava me rezultatin e thellë, 103:81.

Jordan Johnson i realizoi 20 pikë për Pejën. Tyron Flatten i kishte 16, ndërsa Dequan Morris e përfundoi ndeshjen me 11 pikë.

Peja tani ka bilanc prej tri fitoresh e një humbjeje në ENBL.

Fishekzjarrë, fishkëllima dhe nga një pikë për Kosovën e Zvicrën

PRISHTINË 18 NËNTOR - Kosova e Zvicra luajtën 1:1 në "Fadil Vokrri" dhe i mbajtën pozitat në tabelë që i kishin para ndeshjes të së martës mbrëma.

Ashtu si pritej, Zvicra u kualifikua në Kampionatin Botëror të vitit të ardhshëm, ndërsa Kosova do të luajë në plejofin për kualifikim në Botëror. Për Zvicrën është vetëm kualifikimi i radhës në një ngjarje të madhe futbolli. Për Kosovën është sukses historik – për herë të parë do të luajë në plejof për kualifikim në Botëror.

Kishte zhvillime interesante e të papritura në ndeshjen e zhvilluar në fushën e rrëshqitshme e të vështirë në stadiumin në Prishtinë.

Pa nisur ndeshja u ndezën fishekzjarrë, me gjasë për suksesin e Kosovës në kampanjën kualifikuese. Ishte shenjë që kualifikimi në plejof vlerësohej sukses maksimal dhe realizim i synimeve. Për kualifikim direkt në Botëror, Kosovës të martën i duhej fitorja 6:0. Por një rezultat i tillë nuk ishte as afër.

Pak pasi nisi ndeshja, nisën fishkëllimat e tifozëve. Dhe ato u dëgjuan sa herë që kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, e kishte topin në pronësi. Dukej të ishte reagim i tifozëve për një deklaratë të Xhakës lidhur me vendimin e Leon Avdullahut e Albian Hajdarit për të luajtur për Kosovën. Xhaka kishte thënë se Hajdari e Avdullahu nuk ishin pranë ekipit startues të Zvicrës. Deklarata u interpretua në mënyra të ndryshme dhe solli revoltë te tifozët e Kosovës.

Avdullahu e Hajdari nuk ishin në fushë e madje as në stolin e rezervistëve. Selektori Franco Foda i la të lirë, pasi rrezikonin që me kartonë të tjerë të mungonin në plejofin për kualifikim në Botëror, që zhvillohet në mars.

Fishkëllimat ndaj Xhakës ishin thuajse zhvillimi i vetëm në pjesën e parë. Veldin Hoxha kishte një goditje pak të rrezikshme për Kosovën, ndërsa Vedat Muriqi kishte një goditje të pasaktë me kokë. Zviceranët provuan vetëm në minutat e parë, duke shfrytëzuar rrëshqitjen e lojtarëve të Kosovës.

Rezultati mbeti 0:0.

Ai ndryshoi me të nisur pjesa e dytë.

Ruben Vargas e kaloi Zvicrën në epërsi 1:0 që në minutën e 47-të.

Në minutën e 63-të Baton Zabërgja u aktivizua në vend të Veldin Hoxhës, ndërsa Edon Zhegrova në vend të Fisnik Asllanit. Më pas rastin e fitoi edhe Ilir Krasniqi, që në minutën e 71-të e zëvendësoi kapitenin Amir Rrahmani.

Dhe në minutën e 74-t rezultati u barazua në 1:1. Florent Muslija shënoi me gjuajtje mjeshtërore nga distanca.

Kosova më pas e kërkoi golin e fitores, por pa ia dalë.

Te Zvicra u aktivizua edhe Andi Zeqiri, që po ashtu u fishkëllye nga tifozët.

Zvicra e fitoi Grupin B me 14 pikë dhe mund të filloje me përgatitje për Botërorin që mbahet në SHBA, Meksikë e Kanada. Kosova e përfundoi garën në grup me 11 pikë në pozitën e dytë. Tani e pret me shumë interes shortin e plejofit që tërhiqet të enjten nga ora 13:00. Më 26 mars do ta luajë në gjysmëfinale të plejofit, ndërsa shpresat janë se do të sigurohet finalja e plejofit, që zhvillohet më 31 mars. Vetëm katër përfaqësueset që fitojnë finalet e plejofit do të kualifikohen në Botëror.



Xhaka: Fishkëllimat në shtëpi janë gjëja e fundit që kam pritur, dhemb

"Blick" ka publikuar një tekst për fishkëllimat ndaj Granit Xhakës të martën mbrëma në "Fadil Vokrri".

Gazeta e madhe zvicerane ka shkruar se fillimisht ndaj Xhakës kishte duartrokitje e më pas fishkëllima. Fishkëllimat ishin lidhur me deklaratën e tij për Leon Avdullahun e Albian Hajdarin, përkatësisht për vendimin e tyre për të luajtur për Kosovën.

Xhaka pas ndeshjes së Kosovës me Zvicrën ka folur për fishkëllimat. Ai u deklarua për televizionin zviceran, SRF.

"Fishkëllimat janë gjëja e fundit që kam pritur, sidomos këtu në shtëpi", ka thënë Xhaka.

"Dhemb, të jem i sinqertë. Por më duhet ta pranoj këtë. Nuk e kam pritur këtë, por është pjesë e lojës. Çdo gjë është në rregull".

Dihen kundërshtarët e mundshëm të Kosovës në plejof

Kosova do të përballet me Poloninë, Uellsin, Çekinë apo Sllovakinë në gjysmëfinale të plejofit për kualifikim në Botëror.

Këto katër përfaqësuese janë në vazon e dytë për shortin e së enjtes.

Në vazon e tretë janë Irlanda, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova.

Gjysmëfinalet janë më 26 mars, ndërsa Kosova do të jetë mysafire.

Në gjysmëfinale do të takohen edhe përfaqësueset e vazos së parë me ato të vazos së katërt.

Në vazon e parë janë Italia, Danimarka, Turqia dhe Ukraina. Në vazon e katërt janë Suedia, Rumania, Maqedonia e Veriut dhe Irlanda e Veriut.

Finalet e plejofit janë më 31 mars.

Fituesit e gjysmëfinaleve nga vazot dy e tre takohen me fituesit e gjysmëfinaleve nga vazot një e katër.

Nikoqirët e finaleve të plejofit do të përcaktohen me short.

Trajneri i Hoffenheimit për KOHËN: Treshja e Kosovës ka potencial për gjëra shumë më të mëdha

Arsim Maxhera

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Si asnjë klub tjetër, Hoffenheimi i ka tre lojtarë në përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Madje të tre janë startues dhe tashmë prej më të rëndësishmëve në ekipin e drejtuar nga përzgjedhësi Franco Foda.

Bëhet fjalë për mbrojtësin e qendrës, Albian Hajdari, për mesfushorin Leon Avdullahu, dhe për sulmuesin e qendrës, Fisnik Asllani.

Por çka thonë në klubin gjerman për faktin se i kanë tre lojtarë te Kosova, që ka arritur sukses historik me sigurimin e plejofit për kualifikimin në Botërorin 2026?

Trajneri i Hoffenheimit, Christian Ilzer, ka dhënë disa përgjigje me shkrim për KOHËN.

"Për ne si klub është nder i madh. Kjo tregon se po zhvillojmë lojtarë që janë mjaftueshëm të mirë për të përfaqësuar vendet e tyre. Për vetë lojtarët është siguriht shumë e veçantë të përfaqësojnë dhe të arrijnë sukses me ekipet e tyre kombëtare. Është një nder për ta dhe shenjë për ne se po punojmë në mënyrën e duhur", ka thënë Ilzer.

23-vjeçari Asllani te Hoffenheimi u transferua që në vitin 2020. Ndërkohë kishte periudha huazimi te Austria Vjena dhe tek Elversbergu në Bundesliga 2 të Gjermanisë. Te Hoffenheimi u kthye në verën e këtij viti, tani si lojtar shumë i rëndësishëm.

Avdullahu u transferua te Hoffenheimi më 12 qershor të këtij viti nga Baseli zviceran. Rrugën e tij e bëri Hajdari më 25 gusht. Por Hajdari u transferua në klubin e Bundesligës nga Lugano, ekipi tjetër zviceran.

Edhe te Hoffenheimi, njëjtë si te Kosova, Avdullahu, Asllani e Hajdari janë titullarë.

"Të tre janë ambientuar shumë shpejt dhe e kanë shfrytëzuar maksimalisht mjedisin këtu për zhvillim të mëtejmë. Është e qartë se ata po integrohen gjithnjë e më shumë në ekip dhe po bëhen anëtarë integralë të skuadrës sonë. Të tre tani luajnë për ekipin përfaqësues të Kosovës dhe ndihen shumë të lumtur atje", ka shtuar tutje Ilzer.

Trajneri austriak vlerëson se Avdullahu, Hajdari e Asllani janë profile të lojtarëve që i janë dashur ekipit dhe vetë atij. Hoffenheimi bëri ndryshime të mëdha në skuadër gjatë verës.

"Vera ishte fillim i ri për ne, me një grup të ri lojtarësh në ekip. Ne kemi kërkuar profile të caktuara. Leon Avdullahu është perfekt për pozicionin e numrit gjashtë. Albi Hajdari ka cilësitë ideale për qendërmbrojtës. Fisnik Asllani është lidhja perfekte midis mesfushës dhe sulmuesit, si një sulmues i tërhequr. Të tre plotësojnë atë që ne kërkonim".

Hoffenheimi luan në Bundesligë rregullisht nga edicioni 2008/09. Edicionin e kaluar e përfundoi në vendin e 15-të. Këtë edicion, pas xhiros së dhjetë, është në vendin e gjashtë me 19 pikë.

"Ne shohim potencial të madh për zhvillim te të tre lojtarët. Prej kësaj përfiton edhe Hoffenheimi, siç e kemi parë në paraqitjet e tyre së fundi. U urojmë atyre çdo sukses me ekipin e Kosovës dhe shpresojmë që të arrijnë qëllimin e madh për kualifikim në ngjarje të madhe", ka thënë 48-vjeçari Ilzer.



Për të tre Hoffenhaimi pritet të "stacion" drejt klubeve më të mëdha evropiane.

© KOHA Ditore